

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME HAVA SHALËN

Prishtinë | 13 gusht dhe 14 tetor, 2016

Kohëzgjatja: 170 minuta

Të pranishëm:

- Hava Shala (E intervistuar)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Noar Sahiti (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

[Intervistuesja kërkon nga folësjja të tregoj për vetën e saj dhe kujtimet e saj më të hershme. Pyetja është prerë nga video-intervista]

Hava Shala: Unë jam e lindur në një fshat në Lugun e Baranit, Komuna e Pejës, në një familje t'madhe tipike për Rrafshin e Dukagjinit (buzëqeshë), thuajse për pjesën ma t'madhe të Kosovës. Jam fëmiu i parë, i parë i familjes time, respektivisht i pari që iu ka mbijetu... prindërve t'mi iu kanë vdekë pesë fëmi para dhe pas meje. Dhe, ani se kam qenë vajzë, ka gjasa për shkak se kam mbijetu n'mesin e t'gjithë atyre fëmive të vdekur, pastaj kam qenë fëmi që prindërit e mi kanë pasë ni status të veçantë. Në relacion me prindërit e mi nuk jam ndi e trajtuar si vajzë, që njihet pak a shumë statusi i vajzës në familjen e madhe shqiptare, dhe ndoshta kjo ka qenë një lloj privilegji për mua. Mirëpo, në familjen e madhe nuk kanë qenë veç prindërit ata që kanë vendosë për statusin tënd, po ka qenë zakonisht patriarki apo zonja e shpisë në rrafshin e femrave, grave.

E kështu që, në këtë rrafsh e kam ditë pastaj statusin dytësor ose... të qenurit jo aq i rëndësishëm... ose aq i barabartë me të tjerët, siç kanë qenë djemtë, e në familjen tonë kanë qenë shumë të paktë. Mixha im kishte pesë vajza dhe një djalë. Prindërit e mi ma vonë kanë pasë dy vajza dhe dy djem. Kështu që kjo e ka karakterizu pak a shumë jetën time si fëmi, si vajzë me... në etapa të ndryshme të moshës time. Mosha e pubertetit e kujtoj ndoshta me pak specifika të moshës tipike të pubertetit, po me një rebelacion, me një rebelim që ka dashtë me tregu që jo vetëm djemtë kanë të drejtë. Kryesisht, qysh atë kohë jam marrë pak me... në mënyrë krejt spontane me temat sociale, vajza, djali, burri, grua, pse është kjo, pse është ajo... (buzëqeshë). Jo rrallë nëna ime m'thoshte, "E mjera unë, bëhem marak për ty se nuk di cili.... nuk di cili burrë të mban!" (qeshë). Mirëpo, ajo ka qenë jeta ime.

Unë kam bërë tetë vite shkollë, në shkollën e Tushecit dhe kam pasë fatin e mirë që baba im në atë kohë ka qenë si... duke qenë si migrant në Gjermani dhe në Zvicër, gjithësej tri vite sikur ka sjellë pak një frymë të re, një pikëpamje të re për gruan... për vajzat, n'këtë rast për mua. Ka qenë ajo shumë e randësishme dhe une e kam shfrytëzu se osht' përputhë koha, ajo kohë kur e kam kry shkollën fillore me kohën kur baba im ka qenë jashtë si gurbeqar, si migrant. Dhe e kam pasë fatin e mirë edhe me angazhimin e kujdestarit të klasës të ipet e drejta për t'vazhduar shkollën e mesme në Pejë.

Shkollën e mesme e kam vazhduar ndonjiherë ma shumë si djalë, jam veshë si djalë, i kam pre flokët. Insinktivisht ndoshta ka qenë një lloj mënyre e veshëmbathjes për t'u mbrojtë pak a shumë nga mendja që i ka paragjyku vajzat, nëse janë veshë tipik si vajzat. Po flas kryesisht për mendjen, mentalitetin në fshat, ka qenë kohë e vështirë për faktin se na osht' dashtë të udhëtojmë dymdhetë-tremdhetë kilometra në të dy drejtimet, apo tremdhetë, plus tremdhetë kilometra në të ftohtë. Ajo ka qenë noshta ni lloj sfide e natyrës që e ka ndiku ndoshta ni lloj përforsimi t'karakterit të vajzave të Lugut të Baranit.

E pastaj, ishin edhe rrethanat politike që... vitet e '80-ta janë të njohura për të gjithë, kam pasë fatin që t'jem ni person që i ka taku asaj gjenerate ose atyne gjeneratave. Edhe ka qenë... ka qenë një kohë ku domosdoshmërisht osht' dashur të vendosësh cila osht' rruga ime jetësore, a mund t'i mbyll sytë para një realiteti që dhemb, ose a mund t'i hap sytë dhe t'konfrontohem me te? Për cilat arsye ndoshta duhet shumë kohë për t'i shpjegu ato, por po e thomë shumë shkurt që ndoshta nga ajo natyra pak a shumë luftarake që ka qenë, që osht' dashtë me qenë nëse ki jetu në një familje t'madhe e t'ka bë pak ma t'guximshme, ke qenë pak ma e vendosur, ke qenë pak ma... ndoshta ma e gatshme me i hy rrezikut, ndoshta edhe për këtë arsye kam vendosë kryesisht të konfrontohem me realitetin e asaj kohe.

Erëmirë Krasniqi: Ku e keni kry shkollën e mesme?

Hava Shala: Shkollën e mesme e kam kryer në shkollën "Shaban Spahia" dhe dy vitet e fundit në gjimnaz. Respektivisht një vit e gjysmë, sepse në dhjetor të vitit 1984 jam arrestu bashkë me gjashtë vajza të tjera, gjithësej shtatë vajza dhe dy djem. I quajtur atëherë, "Grupi i vajzave në Pejë". Dhe prandaj... ajo arsye thjeshtë politike. Ne ishim angazhuar për t'thanë mendimin e lirë, për t'protestuar kundër gjërave që n'atë kohë ndodhnin ditë përditë, në shkollë, në rrugë. Nuk osht' dashtë t'jesh intelektual, nuk osht' dashtë t'jesh i rritur patjetër, nuk osht' dashtë t'jesh shumë i mençur. Osht' dashtë t'jesh i singertë përballë vetëvetes tande, osht' dashtë t'jesh i vetëdijshëm se e donë një jetë të dinjitetshme për të vendosë të bësh diçka kundër atij regjimi, kundër ndalesave... ose ta ndjekësh rrugën e qyqarit dhe t'thushë, "Dua t'shikoj veç për veten time". Edhe ajo ka qenë e mundur, por për fatin e mirë, ne si shumë të rinj të tjerë në Kosovë, e zgjodhëm këtë rrugën e parë, respektivisht rrugën e konfrontimit të rezistencës, gjë për të cilën nuk jam pendua asnjherë dhe nuk do t'kisha heqë asnjë gjysmë ore nga gjithë ajo kohë.

Erëmirë Krasniqi: Sa vjeçe keni qenë?

Hava Shala: Unë kam qenë 17 vjeç, e kujtoj edhe Roberti ka qenë 17 vjeç, edhe Zyrafetja dhe Myrvetja. Kujtoj që një numër i caktuar prej nesh janë bënë brenda burgut 18 vjeç. Më e reja ka qenë një vajzë e quajtur Emine, ka qenë 16 vjeç, hala s'ka qenë 16 vjeç. Domethanë kemi qenë mes moshës 15 edhe 17, 18 eventualisht. Nuk i kam plotësisht në mendje ditëlindjet e të tjerëve. Po ne jemi arrestu në shkollë n'atë kohë me 19 dhjetor ka qenë ditë e enjte mos t'gabohem, orën e dytë të mësimi në klasë. Osht' një ditë që nuk e harroj se për faktin se ka qenë një ditë shumë e veçantë, një ditë që ka kthi rrugën e jetës tonë në ndrejtim krejt të pa marrun me mend. Ne e kemi ditë se është ni rrugë e vështirë, por se do

t'ketë aq shumë nuanca të errëta... ndoshta për moshën tonë ka qenë e pamundur me pasë ni ide. Unë shpesh herë e thomë, ndoshta për logjikën e shëndoshë osht' e pamundshme me i parapa ato sfida, ato vështirësi. Po ajo ishte pika kyçe e jetës tonë, ktyne nëntë personave, po gjithësesi e shumë e shumë personave të tjerë që i kemi njoftë e s'i kemi njoftë n'atë kohë në gjithë Kosovën.

Siç e thashë, jemi arrestu atë ditë dhe jemi marrë në pyetje. Ndoshta fjala më paradoksale e mundshme që kam taku, e kam thënë, e kam dëgju, e kam taku n'thojëza është fjala marrje në pyetje, sepse faktikisht aty nuk je marrë në pyetje. Aty bile, nëse ke guxu diçka me thanë, ma shumë je malltretu, je torturu për t'mos thënë... kanë pasë frikë nga guximi yt, nga fjala jote, nga mendimi yt. Ka qenë, gjermanisht i thojne ni *höle* [vrinë], një shpellë, një varr si t'thushë, ku njeriu që ka hy brenda ose osht' dashtë të vendosë për t'thanë, "Jam i gatshëm edhe për rrugën tjetër". E cila mund të ishte pastaj varri i vërtetë, edhe natyrisht shpresa ka qenë për një të ardhme tjetër fare, ndoshta shpresa me mbijetu edhe ato gjërat...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë familje keni qenë ju që me pasë këtë prapavi kombëtare?

Hava Shala: Ehh... unë e kuptoj që lun rol, lun rol shumë edhe historia familjare, por jo domosdoshmërisht është... forca e vullnetit të lirë është e njohur në psikologji, e ka njerëz që jo patjetër e kanë pasë një parathënie personale, t'biografisë personale t'veçantë, po megjithatë si karaktere e kanë pasë si predispozicion forcën për t'rezistua. Dhe është shumë normale nëse thuhet që ka njerëz që e kanë vështirë ta akceptojnë... një jetë të padinjitetshme siç ka qenë koha jonë ku je kontrollu, je pshty, je shku tek mjeku 20-30 herë. Mjeku i dhamëve ka thanë, "Bash tek ti nuk kam material për dhamin tand". Pastaj je pshty në autobus, për shembull unë kam pasë një sekuencë ku kanë hy policia në autobus, e kanë ngritë shoferin e autobusit në kamë. E kanë detyru me na shiku neve, edhe e kanë pshy në ftyrë, i ka ra shuplakë në ftyrë për t'na provoku ne. Edhe e ka zgërdhi, e ka përqeshë, e ka detyru prapë t'ulet e t'vozisë ma tutje. Të them të drejtën për asnjë gjë nuk do t'kisha mundë ta bind veten e t'rri e qetë edhe t'i thomë, "Pasi mu nuk m'ka taku, osht' në rregull". Duheshe me qenë idiot shumë i madh, ta thomë sinqerisht, për t'thanë n'atë kohë nuk po bohet kurgjo... "Jam e suksesshme, e kam rrugën time", ka qenë jashtë natyrës time për fatin e mirë.

Mirëpo, edhe në rrafshin familjar ka pasë diçka që sigurisht e ka përcaktu pak edhe formimin e karakterit tim. Mbaj n'mend gjyshja ime ka qenë, nana e babës, një gru shumë burrënore edhe ajo tregonte ndonjiherë sekuenca interesante që mu edhe m'kanë interesu, edhe m'kanë preokupu. Ajo tregonte që si fëmi kishte shku një herë, dhe ajo ka mund me qenë... ajo nuk kish mundësi me e lokalizu pakëz kohën, po ka mund me marrë me mend që ka qenë dikund para ose pas Luftës të Parë Botërore ballkanike. Edhe ajo thotë që ka shku me nanën e saj për ta vizitu vëllain e saj t'madh në burgun e Pejës. Edhe kur janë afër afër, ai paska qenë i pari i katundit të Bërliqit, që osht' një katund afër nesh. Edhe "E kam pa një varrëtar që po e hap një varr", edhe nana e saj, nana e gjyshës time i ka thanë, "Kujt po ia çelë këtë varr?" edhe ai i thotë, "T'parit të Bërliqit".

E thoshte edhe një shprehje tjetër, po qe m'ka ikë prej menjës edhe ajo e ka marrë vesh që ai osht' djali i saj, i madhi. Mirëpo, ajo nuk i tregon gjyshes time, respektivisht vajzës t'saj, sepse nuk donë që ajo

t'alarmohet dhe të qanë, edhe ajo gjyshja ime ishte e befasuar me forcën e saj shpirtërore. Më pastaj, ajo e ka kuptuar tërë historinë kur janë kthyer te shpija, domethënë ka pasë sekuenca ose kam dëgjuar nga burrat, ardhjet e malazezëve, dhunimet që janë bërë, lidhja e burrave me Lugun e Baranit për pemë në dimër, ngrirja e trupit të tyre. E kam njoftë një burrë të Gërvallajve, i vetmi m' duket që e ka mbijetë atë natë të tmerrshme. Kanë qenë sekuenca të cilat pastaj i kanë ngja, pastaj sikur copëzat të një mozaiku. Të tërë mozaikun është dashur ta bëjë vetë pastaj (buzëqeshë), kur jam rritë. Dhe për historinë e malazezëve e kemi pasë një fshatar i vendosur malazet në fshat, i vetmi. Nën timer tona për shembull kanë thanë, "Kur kaloni afër shpisë të Fidakut, mos gaboni me qeshë, mos gaboni me folë t' madhe". Edhe si fëmi kam thanë, "Për çfarë arsye?"

Fëmitë dijnë kaniherë me shtrë pytjen që të mëdhejtë ose frikësohen prej atyne pyetjeve. Dhe unë e kam shtrë këtë pyetje herë pas here, po prindërit tanë nuk kanë dashtë me komentë atë. Edhe ma vonë ti e ki pa se ajo ndalesa, ajo frikë ekziston, edhe kujtoj që edhe ky dimension i historisë familjare ka lujtë sigurisht një rol. Edhe pse unë kam pasë shoqe në burg pastaj, që nuk kanë pasë parathënie të tilla të mëdha të ashtuquajtura, por që kanë qenë shumë të guxmishme. Kanë qenë karaktere shumë të forta edhe unë, edhe kjo ka qenë diçka që m' ka pjekë si njeri, sepse jam shkëputë nga mentaliteti se duhesh patjetër me qenë i një familjes s' madhe, patjetër duhesh me qenë një patriot.

Dhe sikur kam qenë pak a shumë, jo rrallë e irrituar nga kjo pronësi e historisë familjare, e pastaj edhe gjithë Kosovës, e kam... nuk e kam parë si një mundësi t' mirë për t' ardhmen e Kosovës nëse thirrëmi vetëm në të kaluarën, sepse apriori do të thotë nëse ti s' ke pasë një histori t' ngjashme me mua, ti s' mundesh me qenë kaq i mirë... ta them pakëz... me gjuhën politike të Kosovës, herë pas here të dëgjuar n' Kosovë. Dhe unë kam menduar dhe mendoj vazhdimisht që secili njeri ka diçka që... ka t' bëjë shumë me karakterin e tij ose të saj. Në këtë rast ka qenë vendim i imi, ka qenë vendim i imi. Unë s' e kam pytë askënd (qeshë), kujtoj që ka qenë ashtu qysh ka qenë, ka qenë mirë.

Erëmirë Krasniqi: E çfarë aktiviteti keni ba ju me vajzat tjera?

Hava Shala: Ne kemi qenë vajza dhe djem, por për fatin e mirë ne kemi ra vetëm ata që kemi ra atë ditë. Ka qenë një listë e krijuar, nuk e kam idenë nga kush është krijuar ajo listë. Ka pasë arrestime gjithmonë aty-ktu. Nuk di, ose veç çka di... po nuk du patjetër me thanë se osht' dhanë ajo listë, po osht' dhanë sipas mendimit tim edhe për aq sa unë di, osht' dhanë n' tortura shumë t' mëdha të dikujt të arrestuar më përpara se ne. Mirëpo, është mrekulli, dhe e thomë me shumë kënaqësi që prej nesh, prej grupit tonë nuk kanë ra njerëz të tjerë ani se gjatë gjithë kohës... e dijmë prej dhjetorit deri në maj, prill, respektivisht n' maj kemi dalë n' gjyq... n' prill, në fillim t' majit deri në prill. Vazhdimisht ke pasë lista me emra të ndryshëm të mësimdhënësve, njerëzve që ti ke mujtë me i njoftë ose s' ke mund me i njoftë. Edhe je kërcënu, je tortoru për ta nënshkru atë listë. Por mund ta them me shumë kënaqësi sot që ndjej shumë krenari për shokët dhe shoqet e tjera që asnjëri prej nesh, krejt në mënyrë të pavarun prej njëri-tjetrit, nuk kanë bo nënshkrime të këtilla. Dhe pastaj ka qenë ma lehtë të përballesh vetëm me dënimin për veten tande.

Kështu që, po ka qenë ajo marrja e ashtuqujtun në pyetje, respektivisht koha e torturave prej katër-pesë

muajsh ka qenë kohë shumë intensive dhe aty nuk të ka ndihmuar patjetër historia e t'parit ose t'mramit. Aty t'ka ndihmu pikëpamja jote, bindja jote para së gjithash, se ke të drejtë dhe kujtoj vetëm me atë bindje ke mujtë me u përballu pa u çmendë. Jo rrallë, ka ardhë njeriu në skriptë të dhembjes në.... Kujtoj që vetëm njëri që e ka provuar e njëf kufirin e skajshëm të dhembjes që është gati e barabartë me mundësinë për t'u çmendë ose vdekja aty është shumë më pak vdekje. Vdekja do të ishte një rrugë, ndoshta ma e keqja është se aty nuk të lanë të vdesësh. Ose vjen deri aty sa të duket vdekja më e lehtë sesa jeta. Po ajo ka qenë një kohë e veçantë...

Erëmirë Krasniqi: Sa kohë keni qenë e denume edhe për çka?

Hava Shala: Ne jemi... kemi qenë aktiv për faktin se kemi shpërnda pamfletën, kemi shkru vetë një pamfletë si të rinjë të asaj kohe, dhe e kemi artikulu mendimin tonë për çfarë arsye, se ngushtë është kriju, është shumë ngushtë për neve si të rinjë, është shumë diskriminuese gjendja nëpër të cilën po kalojmë. Kemi folë për mënyrat e diskriminimit, kemi folë për të drejtën tonë si njerëz, për t'qenë të lirë si të gjithë njerëzit e tjerë. Dhe kemi shpërnda, kemi shumu, dhe kemi shpërnda para se gjithash në Pejë, por edhe në Istog, edhe në Klinë, edhe në Deçan, mos gabofsha edhe në Gjakovë, edhe në komunat e... në disa komuna të Rrafshit të Dukagjinit ku ne kemi jetu edhe kemi vepru. Thjeshtë ne kemi vepru në këtë mënyrë që po e thomë, kemi lexu natyrisht, kemi shkru, kemi.... Ka qenë mjet i joni i vetëm i ashtuqujtur, luftë e rezistencës tonë ka qenë fjala, ka qenë lapsi, ka qenë... kaq kanë qenë mundësitë tona. Mirëpo, ajo ka qenë ndoshta qysh unë shpesh herë kam dëgju gjatë hetimeve, ajo na ka bo neve hala ma t'rrezikshëm n'atë kuptim, sepse ne kemi guxue të flasim, kemi guxu të shkruajmë. "Është më shumë se veç të shkruash një parollë", atë e thonin ata, unë po i citoj ata.

Ose për shembull, kam pasë një natë, një natë do ta përshkruiej, ishte nata e dytë e hetimeve në Pejë sepse më pastaj na sollën në burgun e Mitrovicës. E në dhomën ku une merresha në pyetje, në këtë natë ishin për çudi dy serbë, në përgjithësi kanë qenë shqiptarë ata që na kanë marrë në pyetje. Po që në këtë natë ka qenë një rastësi ose si rastësi që kanë qenë dy serbë të cilët... njëri prej të cilëve ka folur gjuhën mjaft mirë shqip, mirëpo dallohet që nuk ishte shqiptar. Edhe ajo lodhja ishte shumë e madhe sepse ishin shumë orë pa bukë, pa gjum, pa ujë, pa... ishim të rrahur, unë për vete kam përjetu tri herë elektroskok në gju, në qafë, në dhomë. Edhe elektroskoku din me shkaktë lodhje të tmerrshme, pastaj kanë qenë rrahjet e ndryshme, kanë qenë ata i thonin, tortura me metoda të shpejta që ishin kryesisht rrahje para-mrapa, gjujtje, përplasje dhe gjithëçka ndodhte me t'vërtetë shumë shpejtë. Mirëpo, kishte edhe metoda të ngadalshme që domethanë ti goditeshe taman në venin ku je lëndu, ku është një plagë, ku është dikun e përgjakur. Qëllimisht edhe një herë, edhe dy herë në venin ku veç ishte e lënduar dhe ajo ishte... ajo qeshte, "Metoda e ngadalshme, e butë", i thonin ata me cinizëm.

Dhe këtë natën e dytë, unë isha ulur dhe ata... është gati një natë monstruoze, është një natë e ftohtë, e ftohtë për mua. Është më shumë... ftohja është një shenjë e varrit ndoshta, e vdekjes ndoshta... ata bisedonin me njëri-tjetrin edhe tregonin në mënyrë shumë të qetë, shumë të vetëkuptueshme se çka do t'bëjnë me mua. Ishte një luftë psikologjike, ata donin të më thenin psikologjikisht e shpirtërisht, dhe ata i thonë njëri-tjetrit se ata do t'kërkojnë prej meje të qëndroj në këmbë edhe nëse nuk qëndroj në këmbë, atëherë do të m'godasin me shkop të gomës në lukth në bark. Dhe nëse nuk rri direkt, nëse nuk

rrri tamam në këmbë atëherë do të m'godasin me këpucë në gjunjë. Dhe ata e thonë sikur t'flasim për një ëndërr, sikur t'flasim për një ngjarje para shumë kohërash, sikur t'mos ketë t'bëjë me ata... sikur... ishte një çudi, ishte një.... Më është dashtë shumë kohë me përpunu atë gjakftohtësi të tyre, atë mënyrë, ishte diçka e jashtëzakonshme. Ishte diçka shumë e veçantë.

Edhe aty në t'vërtetë pasi e kryen bisedën e tyre, provuan ta realizojnë, dhe në t'vërtetë edhe nëse... natyrisht që nuk kisha forcë fizike me qëndru n'kambë edhe e bonë atë që e kishin thanë, që e thanë ma përpara. Domethonë, ishte goditje në lukth, në bark, në gjunjë, derisa nuk përplasëshe për tokë. Aty i kam dëgjuar duke thënë që ne jemi ma t'rrezikshme, ne vajzat, gratë, sepse nëse burrave u duhen nji jet për t'u bërë nacionalistë, gratë i bëjnë që n'barkun e tyre. Kjo... kjo thënje, ky mendim, ky artikulum i tmerrshëm i mendjës së tyre, ishte shumë makabër, ishte shumë.... Dhe të them sinqerisht, para se të arrestohem kam qenë e bindur për shumë arsye se kam të drejtë t'i kundërvihem një çmendurie të këtillë. Në burg kam qenë padiskutueshëm, gjithmonë e bindur se kam të drejtë. E ndoshta ajo ka qenë efekti anësor i torturave të tyre, sepse është dashtë me t'vërtetë t'jesh kundër vetes të thuash, "Po tërhiqem nga kjo rrugë, se do t'jem si këta, ose do t'jem bashkë me ata". Domethanë, kanë qenë gjërat për mu shumë të qarta.

Erëmirë Krasniqi: A ishte kjo vetëm në fazën e hetimeve?

Hava Shala: E unë kam qenë... hetimet kanë vazhdu deri me... hetimet e mia kanë vazhdu deri me 11 prill. Me 11 prill, kanë ardhë sërish në... për çudi jo më në ndërtesën e hetimeve, po në zyrën e Sherafedin Ajetit. Ka qenë një, ka qenë një drejtor i shkollës, një i çmendur, një psikopat dhe urrejtës i madh i njerëzores. E kam pasë një karakteristikë që vetëm kur s'kam mund me folë, se e kam thanë mendimin tim. Edhe kështu që, edhe kur flas për atë kohë kam një kënaqësi të brendshme që atij asnjëherë nuk ia kom lanë fjalën (buzëqeshë) e tij edhe e kam thanë mendimin tim me gjithë pasojat.

Atë ditë me 11 prill, kanë ardhë, kanë ardhë me një person që e kam njoftë gjatë hetimeve, edhe ka fillu me cinizëm me thanë, "Ti po mendon që je Shote Galica, ti po menon ashtu..." edhe une i thomë, "Jo, nuk po mendoj". Thotë, "Unë kam qenë në Shqipëri, aty janë listat e zeza", unë i thashë, "Për mu Shqipëria qoftë dhe rroftë sa të jetë jeta. Unë nuk jam për Shqipërinë, këtu ata nuk e kanë nevojën për ndihmën time. Unë jam këtu për mendimin që e kam thanë dhe ka t'bëjë me jetërat tona, me vendin tonë." Dhe atë kohë pat vdekë Enver Hoxha.

Pjesa e Dytë

[Video intervista është prerë]

S'ka problem, aha, po ishte ajo i 11-ti prill, pas asaj grindje me atë personin që erdhi me shpresa shumë të mëdha se pasi ka vdekë Enver Hoxha, nuk ia vlen t'luftohet më për Shqipërinë. Dhe unë i thashë se absolutisht nuk duhet me besu se jam për Shqipërinë dhe Enver Hoxhën, ishte për mu gati një absurd, ajo interpretimi bardhë e zi i qëndrimit tonë. E ai shkoi pastaj, dhe erdhën dy persona tjerë

të cilët nuk i kisha pa gjatë hetimit. Janë dy burra, dhe ata thanë se ose duhet t'ënshkruhet kjo letër, ose sot është dita jote e fundit. Edhe, Shera ishte, Sherafedin Ajeti, ne e kemi thirrë Shera. Ai ka qenë person i veçantë për t'keq. Edhe ai çirreshte, i binte tavolinës, shante, fliste keq shqip, edhe ai... e bëri atë detyrën e vetë edhe më hoqën prej aty. Zyrat e tij ishte n'kuadër t'burgut, nuk ishte në ndërtesën jashtë, jashtë ndërtesës së marrjes në pyetje.

Pastaj ata m'morrën, edhe singërisht kam mendu që po m'çojnë në ndërtesën e hetimeve edhe më pastaj ata po vazhdojnë rrugën me veturë, një lloj xhipi. Ka qenë jo shumë i madh dhe vazhdojmë rrugën të dalur të Mitrovicës. Në perferi të Mitrovicës janë disa kodra jo shumë të theksuara, me mal jo shumë të ngjeshur, ku në një kënd të caktuar këta skajojnë veturën, xhipin edhe hyjnë jo edhe shumë thellë, por pothuaj afër rrugës. Nuk e kam idenë sa ka qenë distanca, por rruga edhe mund t'shiheshte pak a shumë. Në rrugë e sipër, kam menduar disa herë me kapërcy nga mrapa, edhe me provu me marrë timonin e... n'dorë si t'thushë, edhe me lëvizë kah e djathta sepse në të djathtë ishte një zbraztirë, edhe sepse unë isha e pasigurtë në çka po ndodhë me mua. Dalja nga qyteti ishte për mu një pasiguri shumë e madhe. Dhe ata thanë se ishte dita ime e fundit, unë nuk e kisha idenë se çka do t'thotë taman ajo. Dhe unë kisha më shumë frikë nëse do të mendoja se do t'më vrasin do të isha ndoshta ma pak e frikësuar. Noshta, duket shumë absurde, por jo rrallë mundësia për t'vdekë është një rrugë. Më e tmerrshmja është nëse ti ki dëshirë n'thojza, ta thomë në ni moment t'caktuar me vdekë, e nuk guxon me vdekë. Është më e tmerrshme sesa ajo që ti ndoshta duhesh me vdekë. Është gati çmenduri që po e them këtë, po ajo ka qenë pjesa e asaj dite.

Dhe, atje n'atë këndin që e përmenda që sigurisht ndonjëherë nëse krijohen mundësitë, do ta kërkoj atë vend. E kam një... mbaj n'mend... bukur të mirë, gjërat që i shoh me sy, i mbaj n'mend bukur shumë. Edhe aty në... në atë kënd të atij mali, njëri prej tyre e nxjerrë një revolver dhe tjetri i mbështetet tek... ka qenë, ka qenë mbrëmja, as plotësisht terr, as ditë, mes ditës dhe natës. Edhe, njëri i... kerri ishte i ndalur por dritat ishin të drejtuara tek unë, unë isha e ulur te rrënja e një lisi, sepse praktikisht edhe nuk kisha mundësi të rrinja në kamë. Edhe, personi tjetër e nxjerrë një revolver edhe e kontrollon atë pjesën e brendshme edhe thotë, "Ke momentin për ta thanë një dëshirë të fundit ose për t'u pendu". Dhe unë jam sot shumë e bindur që ndoshta kam qenë shumë e gatshme dhe më e gatshme se asnjëherë tjetër me vdekë. Kam qenë shumë e gatshme.

Për mu vdekja është shumë... nuk është ma si për njerëzit e tjerë, sikur e kam përjetuar n'moment, edhe pse n'moment, ky personi në të djathtë përballë meje, ka shti faktikisht me revolver edhe unë instiktivisht ka gjasa kam lëvizë fizikisht. Edhe ata kanë qeshë aq zëshëm, edhe aq zhurmëshëm, ndoshta edhe pse ishte mal, ndoshta edhe pse ishte një gjendje shpirtërore shumë e veçantë, e kujtoj një zgërdhimje, një qeshje që hala ndoshta të tërë nuk e kam harruar. E ndoshta nuk do ta harroj asnjëherë tërësisht, por që e kam kapërcyer. Ata kanë qeshë me atë, se lëvizja ime ishte megjithatë një shenjë frike, e nuk e di se çka kanë folë mes veti, po e di që diçka vazhdimisht kanë thanë, po ajo e qeshmja shumë cinike, shumë idiotike ka qenë. Ka qenë karakteristike e atij momenti.

Pastaj, m'kanë kthyer, edhe sërish në byronë e drejtorit t'burgut edhe kanë thanë që ata kanë dëshirë me dhanë një vulë përmes së cilës do t'i kujtoj gjithmonë. Dhe atë ditë, dhe veprimi i tyre i fundit është

djegja e cigares në dorën time edhe që... me kaq janë kry edhe hetimet e mia.

Erëmirë Krasniqi: Me këtë veprim krejtisht të jashtëligjshëm, a keni pasë të drejtë të ankoheni?

Hava Shala: Jo s'ke pasë të drejtë. Unë kam fillu në... fund të prillit, n'fillim t'majit ka qenë procesi jonë gjyqësor, edhe ata kanë provu edhe disa herë kanë thanë pastaj që pasi tash ka ndryshu gjendja n'Shqipëri, osht' e mundun që ne pendohemi, harrova të them atë që... mu atë ditë ma përpara m'kanë ofru një banesë në Prishtinë, një studim pa studiu, një diplomë pa studiu, nëse pendohem, nëse bashkëpunoj, "Ata kanë ditë me dhanë edhe shkopin edhe sheqerin", thotë një fjalë gjermane. Edhe natyrisht për mu ato kanë qenë plotësisht të huaja. Edhe, në procesin gjyqësor unë kam provu me folë diçka për trajtimin, edhe m'u është ndërpre fjala faktikisht. Është dashtur me shumë nxitim me thanë diçka, përndryshe në proces sapo ti ke dashtë me thanë diçka që ka qenë për ty e rëndësishme, nuk është lejuar.

Gjygji ka qenë i kontrolluar, kanë qenë veç pak njerëz të familjes time. Jemi dënuar në procesin e parë me tetë vite, shtatë vite, pesë vite. Prej tetë viteve deri në... Eminja që ka qenë fare e re edhe s'ka pasë faj fare ndoshta, po ka qenë... ne kemi mbajtur një mledhje në banesën e saj edhe ajo ka mjaftu për t'u dënu një vit. *Also* [Gjermanisht: pra] prej një vit ka qenë rasti me Eminën deri në tetë vite raste me ne të rrezikshmit. Mirëpo, në procesin e dytë më vonë në Zvicër kam kuptu se *International Amnesty* ka intervenu, e kam ba një kopje t'letrës së tyre dhe kam bo presion vazhdimisht. Ndoshta për shkak të atij intervenimi, ndoshta për shkak se ka pasë shumë pak elemente, ne jemi gjyku ma shumë për gjykimin tonë sesa për veprimin tonë. Pastaj instanca e dytë e ka reduktu gjykimin... atë dënimin sikurse për të miturit që do të duhej me qenë prej fillimit duke qenë maksimumimi pesë vite e tutje. Secili ka pasë një porcion.

Unë për veten time i kam mbajtur tërësisht katër vite burg, tri prej të cilave i kam mbajtur në burgun e Mitrovicës për shkak se është quajtur kokëfortësia ime fajtoreshë për mendimin tim. Në fakt hetimet janë kry, por edhe ma tutje je provokuar, je marrë n'pyetje nga të ashtuquajtur pedagogë, anti-pedagogë kisha thanë. Unë kam qëndruar tri vite n'Mitrovicë, dhe në mos gabofsha këtë qëndrim të gjatë... në këtë masë e kam, sa kam dëgjuar nga të tjerët jam e vetmja që e kam bërë deri në këtë... tri vite, për faktin se... unë e kam thanë mendimin tim vazhdimisht. Domethanë, të paktën një herë në javë jam marrë në pyetje nga drejtori i burgut, jam provoku. Po ai ka qenë jo i mençur edhe shpesh herë ka bërë, m'ka bërë gjëra që m'kanë dhënë mundësinë patjetër me ia kthyer ni përgjigje të drejtpërdrejtë. Për shembull, një herë vjen dhe tha që e ka mushë plot, se kishte vazhdimisht arrestime. Dhe gjithnjë e ma shumë, e gjithë ma shumë, e gjithë ma vonë ka pasë njerëz që kanë qenë ma t'bindun, dhe ma shumë, si t'thuash është zgjeruar... është mbushur plot. "Unë jam i suksesshëm" thoshte ai, dhe thashë une, "Ah m'gëzon ky fakt që qenka mbushur plot". Edhe ai thotë, "Po shife se, unë jam i suksesshëm, ju zë kudo që që t'jeni". Unë thashë që, "Mua më gëzon për tjetër arsye se ata që keni shpresuar që do t'frikësohen me dënime të mëdha, janë shtuar, janë bërë kaq shumë sa një ditë ndoshta nuk do t'keni qaq shumë vend". Edhe ai u çu e morri karrikën edhe don me m'ra n'kokë edhe megjithatë kjo osht' realiteti. Edhe ai e ka pasë shumë problem me pasë njeriun që flet, t'paktën ka shpresu dhe është betuar që ose ka me ra n'gjunjë për ta lutë për diçka... ose, ose, ose...ka me qenë, ai ka me tregu që

është më i fortë.

Dhe ka pasë raste, kem pasë një grevë urie diku pesë ditëshe, ku unë kam këndu në burg, kam kënduar edhe para burgut, kam këndue mirë, m'kujtohet (qeshë). E kam pasë kështu pasion, kam këndue në shkollë, edhe n'burg kam këndu shumë... vazhdimisht. Edhe i kam dashtë shumë këngët e lehta. I kam këndue këngët e lehta, i këndoj këngët e lehta. Jam bërë gjyshe, i këndoj nipin tim këngët e lehta (qeshë).... Të ndryshme, po para se gjithash i kam kënduar këngët e lehta. Ne në Rrafshin e Dukagjinit na e ka zanë Shqipërinë edhe i kam dashtë shumë këngët e lehta.

Erëmirë Krasniqi: A i keni përdorë ato edhe si formë komunikimi?

Hava Shala: Këngët jo... komunikimin e kemi pasë...

Erëmirë Krasniqi: Brenda burgut?

Hava Shala: Brenda burgut, me trokitje në mur, ose në rast se janë caktuar hapësirat ku janë bërë arrestimet dhe papritur në mënyrë urgjente, gardianja ose gardianët e kanë lëshu pavijonin, atëherë i kemi pasë.... Se ne në pavijonin e femrave në Mitrovicë, ne nuk kemi pasë dritare. I kemi pasë vetëm mbi derë ka qenë një hapësirë me grila sa për t'hy ajri. Përndryshe, shpesh herë nëse është kriju një mundësi, e kemi vendosë aty një kofe të ashtuquajtur WC-ja e famshme. E kemi vendosë, e kemi lëvizë, ka qenë një kofe e thjeshtë, edhe kemi hypë aty edhe për shembull, e kemi ditë, në burg zhvillohet të dëgjuarit edhe intuita më shumë sesa jashtë, edhe kemi ditë cila shoqe është në cilën dhomë. Ka qenë në pavijonin tonë dhoma numër gjashtë, dhoma numër pesë, dhoma numër katër dhe në mënyrë të veçantë, pothuajse izoluse ka qenë dhoma numër, ose qelia numër tre.

Unë i kam provuar t'gjitha, përveç dhomës numër pesë, nuk e di pse. Edhe ne kemi hypë pastaj edhe kemi pasë shenjat tona, kemi pasë fjalët tona, për ta theksuar në këtë rast, do ta theksoja rastin me Trëndelinën e cila pas një kohe të qëndrimit në një burg të Serbisë përsëri ishte një proces gjyqësor i tyre, ishte kthi atje, unë isha n'dhomën numër gjashtë. Edhe Lina kishte marrë një copë letër, dhe ne kem pasë shumë rrallë, një herë n'javë ose n'dy javë mos gabofsha, për t'shkrua ke pasë t'drejtë në një letër dikujt. Ma shumë e kanë shiku me t'kontrollu çka po thu. Edhe ajo e ka pre me një xham të vogël, spirrë xhami, dikun në gisht edhe në një copë letre që ka pasë të destinume për t'shkruar ndoshta ose një trekëndësh i vogël e kishte shkru, "Hava, unë jam këtu". Edhe e kishte lanë, e kemi pasë një vend në banjo, një vend ku ndonjiherë derisa ka funksionu nuk është zbuluar. E kam qenë shumë e prekur, se ajo e kishte shkruar me gjak, gjaku nuk rrin si ngjyra... kam qenë shumë e prekur domethanë. Në një mënyrë, ose në një mënyrë tjetër është bërë pamundshme me i tregu njëra-tjetrës që jam këtu, n'atë kuptim nuk je vetëm se unë kam qëndru bukur gjatë pastaj vetëm.

Erëmirë Krasniqi: Atë e njifshe prej...?

Hava Shala: Atë e njifsha prej ma heret, Trëndelinën, e kisha njoftë prej më përpara, sepse kur rrin njeriu gjatë në burg ke rast për t'i njoftë të gjitha t'burgosurat pothuaj, që janë arrestu n'atë kohë, qoftë edhe nëse nuk i ke parë ose veç nëse je dëgju me to.

Erëmirë Krasniqi: A e kishit kohën rekreative jashtë?

Hava Shala: Jo, jo, s'kishim, jo s'kishim. Kishim të drejtë të leximit nëse je shumë e dëgjushme. Unë isha në qeli me dikë tjetër, t'paktën e kisha mundësinë me lexu librin e tjetrës, sepse ishte parakusht nëse ti socializohesh sipas kuptimit të këtyre, atëhere kishe privilegje. Përndryshe, nëse ti ishe në linjën tënde, atëhere zakonisht dënoheshe me vizita, ka pasë raste me javë të tëra që nuk e ke pa familjen, ose me libra që ishte hala ma e tmerrshme sepse ishte... hapësira ishte shumë e zbrazët. Mirëpo, megjithatë krijoheshin mundësitë, krijoheshin mundësitë. Kam lexu me qef, edhe libri ma i keq në botë, e merr ... ka kuptim, lexon, merresh me diçka.

Ma s'keqi ka qenë ditët e fundit. Gjashtë mujë, gjashtë mujë e gjysë kam qenë vetëm në qelinë numër tre. E ku kam qenë me shëndet shumë, shumë, shumë keq, s'kam pasë ma mundësi me ecë, kam pasë vazhdimisht diare. Edhe ajo ka qenë masë ndëshkimi për shkak se une u grinda me drejtorin. Erdh një komision i Jugosllavisë së atëherëshme për t'i verifiku standardin e lartë t'burgjeve tona, që ishte një tmerr në fakt, por ata improvizonin. I mbulonin bukur ato, mundoheshin me gjëra... aty për atyshme me kriju një performancë. Mirëpo, dyshekët që i bijshin, ishin tre, ishin të dobët. Shpesh herë hekuri i krevatit ma shumë t'dhimte trupin prej tyre sesa.... Edhe gjërat ishin, WC-ja ishte brenda, fekaljet ato... kundërmonin. E mira ime ka qenë që s'e kam pasë hundën mirë të zhvilluar, për fatin e mirë timin (buzëqeshë). E kështu që, mirëpo ka qenë sigurisht për ato që kanë ndi erënat ka qenë shumë vështirë, sidomos në kohë vere.

E për t'dalë, kemi dalë në shëtitje kush ka pasë mundësi. Ka qenë një shëtitore *also* [pra] burgu i Mitrovicës ka qenë... ka qenë rreth edhe ka qenë i ndarë me mure shumë të larta në... katësh. Dhe në kryqin e atyre katë mureve, respektivisht dy mureve që kryqëzonin njëra-tjetrën, ishte vendi ku rrinte polici, roja i armatosur. Edhe ne e kishim një copë torte t'atij rrethi, në thojëza, domethanë ishte ajo çimento trekëndëshe, ato mure shumë të larta. Nëse kishe mundësi me ecë, atëhere lëvizshe pesë minuta në rreth, nëse jo atëhere rrijshe brenda. Dhe lëvizjet kanë qenë shumë të kufizuara. E në banjo na kanë çu dy herë, në mëngjes dhe në drekë... pas drekës. Për t'hangër kemi pasë tri herë, dy herë kemi pasë dy lugë çaj, bukë eventualisht, djath të prishur, e në drekë kryesisht ka pasë makarona e shpesh herë me vajin e hedhur t'pa zier në sipërfaqe, prandaj kemi pasë shumica diare. Nëse ka pasë mish, ka pasë mish me lëkurë dhe çime, qoftë të derrit, qoftë të kafshëve tjera. Ushqimi ka qenë shumë i dobët.

Kemi ra në ora nantë, jemi çu në ora pesë me bori. Gjatë tërë ditës nuk ke pasur t'drejtë të pshtetesh, të ulesh në krevat, është dashur në dysHEME, kambëkryq. Ne kemi qenë të ushtruara. Siç e thashë, për nevojat tjera ka qenë një kofe, improvizimi i një WC-je. Vizitat kanë qenë sipas dëshirës së tyre. Leximi gjithasthu ka qenë sipas dëshirës së tyre. Drita ka qenë shumë e fortë brenda, nëse ka qëndru dikush gjatë, është dashtë patjetër t'kesh syza më vonë. Si dënim ka qenë edhe marrja e syzave nga ana e drejtorit me kusht që t'mos mundesh me lexu, ose me pa si duhet. Siç e thashë, gjashtë mujtë e fundit kam qenë vetëm. E kam pasë t'ndaluar... ah po, isha e emocionuar pakëz edhe e bëra një ngatërrim kohor. Ai komisioni që erdhi, erdhi një ditë ma vonë pasi në mbërmje u rrah shumë një Vezirja, një shoqja jonë në dhomën numër pesë. Aq shumë sa ne protestumë edhe kujtoj gjëja më e vështirë

n'burg është kur dikush tjetër rrahet dhe jo ti, se je aq i pafuqishëm për ta mbrojtë sa është një gjendje e jashtëzakonshme.

Edhe ne ishim shumë të irrituar dhe ai drejtori erdhi afër meje, fare afër meje, fare afër ftyrës time {afion shuplakën para ftyrës} e me një qeshje shumë cinike, pasi u kry ajo ceremonia e vizitës ata njerëzit ishin hala jashtë, por u tërhoqën pakëz. Edhe tha, “Çka do t'bëjshe me mua nëse do t'vinte koha jote?” Dhe për shkak se unë isha shumë e lënduar për Veziren edhe ishte një gjendje emocionale shumë e veçantë, unë i thashë, unë i thashë një mënyrë që as që e kisha menduar. Absolutisht përpara s'e kisha menduar që do të m'bje rasti për t'i thanë, e dyta s'e kisha menduar që do t'ia them në mënyrë aq të qetë, absolutisht s'e kisha menduar. Ishte një thënie e imja, krejt e pamenduar, por qind për qind e bindur se ashtu duhet t'jetë. Nuk kam një shpjegim se si e kam... ishte aq irrituse ajo ardhja aq afër, ajo aq cinike, aq jonjerëzore. Sa që unë i kam thanë, në mënyrë shumë, shumë, në mënyrë shumë të qetë, jashtëzakonisht të qetë, e kam të pashpjegueshme për veten time, i kam thanë, “Do t'vrisja”. Edhe ai tmerrohet.

Unë e kisha Xhemilen, Xhemile Hysenin ka qenë agronomja e parë e Kosovës. Ka qenë e burgosur politike gjithashtu. Edhe ajo thotë se, kam mendu se t'ka lanë mendja. Dhe unë kam qenë e... edhe sot e kam të pashpjegueshme, kam qenë shumë e qetë. Ka gjasa, gjithë fiziku im ka qenë i bindur që duhet me i thanë në atë moment diçka të këtillë. Dhe ai është tmerru aq shumë, dhe është tërheqë aq shpejtë mrapa dhe është irritu që i kam thanë në sytë e të tjerëve... ai s'e ka pasë idenë ndoshta. Edhe tha që, “Shumë shpejtë do ta shohësh se si do t'më vrasësh” (buzëqeshë). Edhe pas gjysë ore, erdhën edhe m'morrën me pak gjëra që kishim n'burg. Kemi pasë gjithmonë pak rroba, aq sa lejohej dy-tri gjëra. Por për fatin e mirë e mora me mend se diçka do të ndodhë, dhe i mshefa ato pak gjëra t'miat, librin e poezive të Bertolt Brecht-it dhe Yannis Ristos. Dhe të dy kanë pasë poezi jashtëzakonisht të mira dhe të dytë kanë pasë... Yannis Ristos ka qenë vetë i burgosur politik në Greqinë e asaj kohe.

Eh... edhe i kam ato gjashtë-shtatë muaj kam qenë fizikisht shumë keq se kam pasë problem me ecë, kam pasë problem... fizikisht me t'vërtetë nuk kam besu që do t'dal prej aty gjallë, po është dashtë të mobilizohem në të gjitha mënyrat e mundshme. Ndoshta aty e kam përjetu, nëse n'hetime e kam përjetu kufirin e skajshëm të dhimbjes fizike, në dhomën numër tre, n'qelinë numër tre e që osht' izolim i plotë, e kam përjetu kufirin e skajshëm të... mendimit, të menduarit logjikshëm. Kam pasë frikë se nëse nuk flas diçka, nëse nuk thomë diçka është e mundur që papritur nuk mundem ma me mendu logjikisht. Respektivisht mund të çmendem.

Edhe kam improvizu të gjitha mundësitë e ndryshme, si kangë, si recital, si dramë, si... lexim nga poezia e parë, nga e fundit, nga e fundit në të parën. Kombinim të kësaj poezie të Yannis Rist. Ato libra i kam pasë për gjashtë muaj e diçka, e kanë qenë shokët e mi më t'mirët. Edhe kam kënduar, kam kënduar, kam kënduar, jashtëzakonisht shumë. Askund ma bukur kënga nuk tingëllon sesa në burg (buzëqeshë).

Erëmirë Krasniqi: A kishit mujtë me na knu ni kangë?

Hava Shala: Po... kam... kënduar, po natyrisht për shembull që i përket pak edhe gurbetit, për

shembull... ose ni sekuencë të ni këngës që e dëgjoj me qejf, po unë veç ni sekuencë. Për shembull këngën... [këndon] “Ejani o shokë të pimë” (qeshë), ni sekuencë, të tërën sigurisht tash nuk mund ta riprodhoj. [Vazhdon të këndoje] “Ejani o shokë të pijmë, të pijmë një gotë raki, ejani o shokë të pijmë, se s’bëhemi më të rijë. Se vitet shkojnë e ikin, dhe ikin një nga një, se vajzat bëhen plaka, rinia moj nuk vjen më”. Për shembull hë, ose [këndon] “Vajta kalova tërë Kalabrinë, askun s’e gjeta, mëmë Shqipërinë. Vajta kalova, tërë Kalabrinë, askun s’e gjeta mëmë Shqipërinë. Dy trandofile në dorë i mbaja, ia fala njërën arbëreshes sime. Dy trandofile në dorë i mbaja, ia fala njërën arbëreshes sime. E lum, e lum...” dhe kaq (qeshë). E kam harru dhe rradhën, po i kam kënduar këto. *Also* [pra] në burg, ushtron njeri më shumë, ka gjasa gjatë kohës, kam këndu taman. Edhe me Trimin e vogël, me nipin këndoj, por i këndoj këngë që janë pak edhe për moshën. Ama këngët e lehta i kam pasë shumë për qejf, edhe të tjerat natyrisht.

Tamam... kjo ishte koha në Mitrovicë, e një sekuencë e fundit për burgun e Mitrovicës sepse me siguri do t’duheshin njeriut gjatë kohë me bisedu. Në ditët e fundit të qëndrimit tim në qelinë numër tre, isha gati e palëvizshme, edhe vazhdimisht kisha, kisha... dobësi fizike të cilat ndonjëherë ndoshta kanë qenë gati e një shkallës ku njeriu e hupë vetëdijen. Dhe papritur ose m’ka ardhë vetëdija në burgun... në spitalin e Mitrovicës ose jam bartë e vetëdijshme në spitalin e Mitrovicës, edhe ajo është diçka e veçantë që e kam thanë, dhe e thomë vazhdimisht. Një prej atyre ditëve që bukur shpesh në javë, dy javët e fundit, herë pas here çohem n’spital me një infuzion, yh kthehesha.

Edhe një ditë prej ditëve vjen një mjeke e cila ishte shefe e repartit, edhe ajo fliste serbisht edhe me shumë gjasa mund të ishte një serbe ose boshnjake. Për mu s’kishte rëndësi, ajo ishte një grua që e fliste gjuhën tjetër dhe që mund të ishte shumë e besushme e kohës, sepse ajo fliste gjuhën e administratës dhe t’regjimit që ish këtu, dhe apriori kishte një pozicion tjetër fare. Ajo erdhi tek unë edhe atë ditë para pak çastesh, një motër medicinale, mua m’erdhi vetëdija ose t’paktën diçka e pa që dëgjova në spital. Tha, “Unë jam filan fistekja...” nuk e mbaj n’mend emrin, e kam dobësi nuk i mbaj n’mend emrat. Ata njerëzit që i dua dhe iu di emrat për çudi... nuk i mbaj n’mend. Edhe ajo tha, “Unë jam filan fistekja”, dhe tha, “Për çfarë arsye je ti këtu? A e din për çka je këtu?” Thashë, “Jo, ma merr mendja, por n’fakt nuk e di”. Tha, “A ke dëshirë me ditë?” Thashë, “Në fakt unë diçka di, por saktë pse jam sot këtu, unë nuk e di”. Tha, “Unë kam dëshirë që ti ta dijshe pse je këtu. Edhe kam nevojë për besimin tand, sepse duhet me bisedu diçka me ty”.

Ishte diçka e çuditshme sepse ishte diçka njerëzore që ishte... nuk i shkonte për shtati, nuk isha mësu me taku njerëz në këto kohë, ose t’paktën jo zyrtarisht, si t’thushë, me pasë një detyrë zyrtare dhe me qenë njerëzor... jo. Kisha pa gardianë e gardiane që msheftas tregonin pakëz njerëzillëk, por jo n’këtë detyrë. Ajo tha që... “Po,” thotë, “unë, ta dijshe që mua më është kërkuar që t’nënshkruaj vdekjen tande”. Edhe thashë, “Ata bëjnë punën e tyre, edhe une e bëj punën time”. Ajo... iu mbushën sytë me lotë edhe e mbaj n’mend si sot, u ul afër krevatit tim, kështu veç pakëz edhe tha, “Ama, unë nuk do ta bëj atë”. Thotë, “Ti nuk je e sëmurë, ata janë të sëmurë”. Edhe tha... ta thomë në shqip, “Mallkuar qoftë, unë jam veç një nanë, edhe unë kam dy vajza”. Ajo ishte e tronditur prej asaj dhe thotë, “Unë nuk e bëj atë, unë nuk do ta bëj. T’jesh e bindun që nuk do ta bëj. Ama, unë kam dëshirë, kam nevojë për

mirëkuptimin tand, sepse sot do t'marr një vendim që mund të jetë një shancë për ty edhe mund të jetë gjithashtu dhe një rrezik, por është e vetmja rrugë me e hapë një mundësi tjetër për ty. Do t'i thomë drejtorit..." Drejtori kishte dëshirë personalisht me m'përcjellë, se ai ishte betuar që ka me m'pa mu në një gjendje ku unë do të thehem sipas mendimit t'tij.

Edhe pas pak kohe, ajo u betua se nuk do ta bëjë edhe u betua se do t'ia ndalojë sjelljen time të matutjeshme drejtorit t'burgut në... sjelljen time në spital, me motivacion se unë nuk jam e smuar. Edhe kur erdhi drejtori, ajo me t'vërtetë e la derën pak çelë {dëfton kah dera} edhe të betohna që ajo i tha pak a shumë të njejtat gjëra që i bisedoi, respektivisht m'i tha mua. Edhe m'bëri pështypje guximi i saj, edhe m'bëri përshtypje guximi i saj dhe ana e saj njerëzore. Në atë kohë ishte shumë e rrallë, ishte shumë jashtë normalitetit {bën thonjëzat me duar} t'krijuar n'atë kohë. Dhe mund t'them sinqerisht që nëse kam qenë deri n'atë kohë pak nacionaliste, t'jesh e bindur që prej atij momenti kam qenë shumë ma shumë njerëzore se sa nacionaliste.

Edhe unë kujtoj që në përvojat e mia jetësore, një përvojë të këtillë nuk do ta çbëja për asgjë, sepse e kam parë, ani pse ka qenë një pikë në oqean, po edhe ajo ka qenë diçka, ka qenë një njeri, që thojnë një njeri i vetëm. Ka qenë si Bertolt Brecht-i për shembull, është e pakrahasueshme për nga dimenzionet, por si Bertolt Brecht-i që osht' çu kundër çmendurisë së popullit t'vetë n'atë kohë, edhe ajo ishte një Bertolt Brecht i vogël në mënyrën e saj, me mundësitë e saj, me mjetet e saja, ishte për mua, për mua ishte ky krahasim i mundshëm n'atë kohë. Edhe sot e kësaj dite e çmoj atë guxim edhe kujtoj që ka kriju një pjekuri timen në rrafshin horizontal, në rrafshin e përvojave që janë pjesë e rëndësishme e jetës tonë, e formimit tonë.

Erëmirë Krasniqi: Çka kishte me ndodh me ju nëse ajo nuk ju kishte ndihmu?

Hava Shala: Edhe ajo kërkoi thjeshtë, ajo... Jo ata e kanë ditë që unë gradualisht do t'vdes, se unë faktikisht isha shumë e dobët isha, jashtëzakonisht e dobët, mo as s'mund t'ecja, mund t'flija shumë keq. Ushqimin që e haja, organizmi nuk e pranonte mo, në fakt unë isha... gradualisht do t'vdisja. Ama, unë do t'vdisja për shkak të mungesës së ushqimit, për shkak të mungesës së lëvizjes, për shkak... Unë isha plotësisht e rrethuar, s'kisha mo shëtitje, unë s'kisha mo me shku n'banjo, shumë rrallë bonja ni tush, faktikisht unë isha gati, unë edhe vetë kam besuar se do t'vdes. Pastaj kur jom bartë në burgun e Lipjanit, kam mësue me ndihmën e grave tjera, kam kriju prapë mundësinë për t'ecë edhe për... si t'thushë si fëmiu që mëson sërish ecjen. Ata e kanë ditë që unë shumë shpejtë mund të vdes edhe une e kam ndi atë, e kam pa si t'thushë. Ajo vetëm o dashtë pastaj me firmosë se unë kam vdekë nga një pushim i zemrës ose nga një... ku di gjë une se si, por ajo nuk ka dashtë me bërë atë. Dhe ajo i tha drejtorit që, "Unë nuk dua që ta sjellësh këtë më në repartin tim. Ta ndaloj ta sjellësh! Ajo nuk është e sëmure, ju jeni të sëmure". Beso që ato që ajo m'i tha mua, ajo ia tha atij edhe në fakt prej asaj dite ata nuk m'çunë më n'spital, por u detyruan me marrë një masë tjetër dhe ajo ishte heqja ime nga burgu i Mitrovicës.

Faktikisht ashtu ndodhi, brenda një javë a dhjetë ditëve ma shumë... nuk... njeriu e humbë masën e kohës në burg, erdhën edhe m'morrën. Dhe unë isha e sigurtë që po m'çojnë në Serbi, se e kisha vetëm

edhe një vit burg, ama ishte e mundshme, thashë n'Serbi gjejnë.... Aty mendja ime, dhe m'erdhi shumë keq për familjen time. Për herë t'parë m'erdhi shumë keq, për shkak se edhe gjendja financiare ishte e vështirë, edhe gjendja emocionale dhe t'gjitha ato. Mirëpo, për çudinë time më sollën në Lipjan. Dhe aty ishte si t'thushë rilindja ime, ose lindja e sërishme për t'mos bo paralele n'mes Rilindjes. Mirëpo aty edhe kam përjetu çaste interesante ose shumë specifike. Pas tri viteve e kam parë veten për herë t'parë në një pasqyrë në dhomën e pritjes, ku njëra palë dorëzonte dhe pala tjetër vinte për t'marrë. Aty ishte në derë një pasqyrë bukur e madhe edhe e kam parë veten për herë t'parë në pasqyrë. T'betohem qat' kohë kom pasë problem me e shiku veten n'pasqyre se s'kishte qenë as... për mua ishte një person fizik krejt tjetër fare.

Mirëpo, Lipjani ishte një prej burgjeve ma normale i asaj kohe, sepse ishte rishtazi i ndërtuar. Dominonte ma shumë... ekipi udhëheqës ishte shqiptar, i kishin edhe ata dreqnit e vetë edhe ato, por megjithatë kishte diçka ma shumë hapësirë. E keqja e Lipjanit ka qenë se jemi t'detyruar t'punojmë. Unë pak a shumë e kam sabotu punën, edhe për shkaqe shëndetësore, por s'kam qenë e bindur që duhet me punu qaq shumë, edhe ashtu... Mirëpo, kanë qenë edhe shoqet, shoqet kanë qëndru bashkë, n'shumë aspekte burgju i Mitrovicës ka qenë i pakrahasueshëm me burgun e Lipjanit. Dhe në burgun e Lipjanit e kam kryer vitin e fundit dhe jam liruar tamam me 19 dhjetor, katër vite më pastaj, të vitit '88, në kohën e minatorëve, në kohën e protestave... në kohën që quhet koha jonë...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ishte pas lirit, kon e kishit jashtë, qysh...?

Hava Shala: Eh... në fakt, ma shumë n'rrafshin individual kisha problem në familje, gjithçka që kishte t'bante me përditshmërinë m'dukeshte banale, m'dukeshte jo shumë e rëndësishme, m'vinte çudi nëse njerëzit flasin për pak të korra, për pak të marrura, për... tatimin e.... Njerëzit e fshatit e kanë pagu me kafshët, aty vinin njerëzit edhe i merrnin kafshët. Natyrisht, se fshatari mërëzitet nëse merret ma shumë kafshë ose ma shumë drithë ose ma shumë grurë. Këto tema, pas daljes nga burgju ishin për mua shumë banale. Ishte... deshëm, s'deshëm ndodhë një lloj tëhuajësimi i njeriut për shoqërinë. Mirëpo, ne kemi pasë shokë, kemi pasë shoqe, kemi pasë një lidhje shumë t'veçantë. Ideali është diçka që i lidhë njerëzit më fortë. Kujtoj nganjëherë se sa edhe familja... po flas për rrethana t'aktuara, e sidoqoftë familja ime ka qëndru pranë meje. M'kanë përkrahë edhe në kohën e burgut, kam pasë prindër shumë t'arsyeshëm, shumë të mirë, e nuk e kam pasë fare atë problem. E kam pasë problem, se nuk e mbarova maturën në Pejë, edhe është dashtë me i kompenzu përmes provimeve. Drejtori i burgut ishte shumë lojal për kohën, për regjimin, u betu se një armik si ti nuk do i jep asnjëherë provimet këtu. Por si gjithmonë ka pasë njerëz shumë t'mirë, dhe dua ta theksoj kte. Kujtoj që falë njerëzve të mirë krijohen konjuktura të mira në koha të vështira.

Edhe drejtori për fatin tim personal të mirë ishte thirrë për një seminar, sigurisht instrukcionet u duheshin t'i merrnin atyre në Beograd. Dhe unë dëgjova prej sekretarit të shkollës që osht' qujtë Shala gjithashtu, po s'ka qenë fare kushëri i im dhe nuk e di dhe prej kah ka ardhë, po ka qenë shumë, shumë i mirë. Ai... dhe kujdestari im i klasës Riza Krasniqi dhe mësimdhënësi im i matematikës, dhe msusët tjerë që kanë qenë gjithë të mirë. Dhe nuk e di përmes kujt, por m'kanë njoftu te shpija se mund të bëhem gati për t'i dhënë provimet në kohën sa ishte drejtori i shkollës në Beograd. Edhe në fakt,

provimet do t'mund t'i kisha dhënë në mënyrë shumë të përgjithshme. Në burg ka mundësi njeriu me lexu, leximi sigurisht e çon njeriun më lart, por nga përmbajta sigurisht që kam qenë larg një nxënëses t'mirë për t'i dhënë provimet ashtu shpejtë e shpejtë (qeshë).

Por siç e thashë, në atë kontekst e kam bërë një kompromis me vetëveten, se shpesh herë jam bukur e rreptë me veten time, me principet e mia. Mirëpo, aty e kam ditë që një prej mundësive të mia është nëse largohem dhe vij në Prishtinë, qoftë për t'studiuar, qoftë për t'krijuar pakëz anonimitet sepse faktikisht, ne kemi qenë, deshëm s'deshëm, të përcjellur. Vetura e policisë jo rrallë ka qenë tek dera jonë. Njerëzit janë marrë n'pytje. Unë kam pasë historia tjera që ndoshta njeriu shumë gjatë me... më shumë kohë për t'i thanë të gjitha. Por... ishte një mundësi për t'dalë pakëz nga provinca ku ti si... ashtu i definuar si armik i popullit n'thojëza, e kishe shumë t'vështirë me lëvizë. Edhe në fakt, unë pranova ofertën e mirë të msusëve të mirë të mi, dhe i dhashë provimet ashtu shkel e shko. Sigurisht me përjashtim ndoshta të gjuhës [shqipe], ku e kam pasë një temë interesante për letërsinë diçka. Po... ka qenë nëse s'gabohem, ka qenë poezia e Migjenit dhe une e kam dashtë Migjenin dhe poezinë e tij.

Edhe, ajo që e vetmja gjë në të zezë që e kam bërë në jetën time ka qenë pranimi i një teme diplome të një x personi, që ky zotëri Shala, që për fat t'keq ia kam harru emrin, e kishte përgatitë se une s'kisha kohë mo për t'përgatitë temën e diplomës, temën e maturës. Edhe, e di që e dua ta them publikisht që m'vjen keq dhe vetëm mundem me ia falë vetëvetes, vetëm për faktin se kam dashtë domosdoshmërisht me ik pak nga hapësira e ngushtë atje dhe ardhja në Prishtinë, pastaj ka qenë një shancë për mua. Vetëm ashtu mundem me arsyetu atë pranim symbyllazi të një teme t'diplomës, që as që e di kush e ka shru, aty është bërë një dallaver. E kanë qitë kopertinën e parë me emrin tim, e kam përbi me shumë vështirësi atë ofertë. Edhe pse ata kanë thanë që është një formalitet, po që është një parakusht për me ardhë në Prishtinë. Mirëpo, dhënia e provimeve ashtu qysh ishte dhe marrja e kësaj diplomës t'famshme që nuk ishte diplomë e imja, e krijumë parakushte për t'u regjistru në fakultet. Dhe në fakultet në fakt kam studiuar. Në fakultet nuk i... përveç miqëve, njerëzve të caktuar që kanë ndihmuar procesin e... në procesin e regjistrimit sepse ne s'kishim letërnjoftime. Gjërat ishin të vështira për shkak t'dokumentacionit.

Përndryshe për studime, kam studiuar me shumë qejf, kam studiuar letërsinë dhe gjuhën. E kam dashtë letërsinë popullore, por e kam dashtë edhe letërsinë e hershme t'shkruar. E kam studiuar me shumë qejf, "Këngët e Milosaos", e kam studiar letërsinë e hershme, m'ka interesu shumë aspekti social i letërsisë t'mëparshme. M'ka interesu shumë koha para otomane, dhe më pastaj kam dashtë vetes time me i dhanë një shpjegim si kemi qenë dhe si jemi dhe si mund të jemi. Në rrafshin e studimeve, edhe pse ka qenë kohë e çmendur në rrafsh tjera, e kam bërë me shumë qejf dhe për ate mund të them që e kam... i kam, e kam bërë me shumë.... E kam bërë me forcat e mija dhe prej vetes time.

Paralel me studimin, që nuk ka qenë prioritet për shumë studentë, por për mu ka qenë i rëndësishëm, po prioritet kanë qenë n'atë kohë rrethanat, kanë qenë lëvizja e minatorëve që pati efektin e një tërmeti në det që rrathët e atij tërmeti në kuptimin pozitiv e përfshin gjithë popullin. Unë isha hala në Lipjan kur ishte greva e minatorëve dhe ajo pajtimi i gjaqeve, ajo ide e tyre e të tjera. Ata sollën një lëvizje në

vete, jo vetëm n'rrafshin politik. Po dikur sikur u provoku n'kuptimin pozitiv me një shqiptare dhe në ato skutat e errëta ku kemi mbetur më shumë të palëvizshëm, siç është vëlla vrasja, po edhe pozita e gruas në përgjithësi. Edhe aty unë isha, isha pjesë e shokëve dhe shoqeve të mia në Prishtinë, pjesë e protestave, korzo-ja jonë e shkollës e rezistencës është korzo e protestave, është korzo e sakrificave, është korzo e konfrontimeve t'jashtëzakonshme, ajo është korzo-ja ime, korzo-ja jonë. Prandaj nuk ke pasë mundësi fare me u ndi vetëm për fatin e mirë. Për fatin e keq ne edhe kemi humbë pastaj shokë n'atë kohë. Ka pasë arratisje të mëtutjeshme, ka pasë vrasje.

Erëmirë Krasniqi: A ishin këto protesta për univerzitet, apo?

Hava Shala: Jo, ishte n'ato për... koha e Millosheviqit, heqja e autonomisë, pastaj Universiteti ma vonë. Si rrjedhojë e logjikshme e t'gjitha këtyre proceseve ishte pastaj edhe aksioni i pajtimit të gjaqeve që filloi në shkurtin e vitit '90, në kohën e demonstratave më të...

Pjesa e Tretë

[Kjo pjesë e intervistës është realizuar më 14 tetor, 2016]

Erëmirë Krasniqi: Zonja Hava, a kishit mujtë me na tregu pak ma detajisht për situatën politike n'vitet e '90-ta?

Hava Shala: Po, mundem me tregu nga këndvështrimi im natyrisht. Unë u lirova nga burgu në fund të... me 19 dhjetor 1988-tën, tamam pas katër vitesh burg. Dhe ishte ajo kohë e mbushur me plot ngjarje t'rëndësishme, t'veçanta siç ishin protesta, greva e urisë t'minatoreve. Në atë kohë, unë isha hala në burgun e Lipjanit, vitin e fundit t'burgut e kam bërë në burgun e Lipjanit. Edhe, edhe ne natyrisht edhe nga brenda i kemi përjetu ato ngjarje, i kemi përcjellë, kemi marrë pjesë edhe nga distanca në to. Një temë që ka qenë e rëndësishme, shumë e rëndësishme dhe që ne veçanërisht na ka prekë. Në kohën e burgut, ka qenë idea e disa minatorëve për t'falë disa gjaqe, ose idea për t'i falë gjaqet. Mirëpo, atëhere ne ishim në burg edhe kemi... me ni shoqen time shumë të mirë, shumë të dashur me Akile Dedincën e kemi biseduar çka mund të bëhet qoftë edhe nga brenda. Dhe, kem pasë menduar me shkru një shkresë edhe me qitë diqysh jashtë përmes shokëve dhe shoqeve aktiviste, jashtë, që me bërë diçka në këtë drejtim. Mirëpo, kushtet erdhën gjithnjë e më shumë tu u vështirësu, jashtë edhe brenda. Edhe ajo mbeti veç një dëshirë, një temë, një nevojë ma mirë me thanë, e jona për me bërë diçka, por mundësitë ishin t'vogla. Ishte e pamundshme me bërë diçka nga brenda.

Pastaj unë u lirova dhe ishte '89-ta. Me shumë ngjarje tjera, me shumë protesta [kjo] e '90-ta, me heqjen e autonomisë, me kufizimet të shumta, me përjashtime nga puna në mënyrë masive të shqiptarëve, me ndërprerjen e të drejtës për shkollim. Domethanë, ishin procese shumë të vështira ku shqiptari ose njeriu i këtij vendi, njeriu i ynë siç thotë Qosja, ishte gjithënjë ma i ndaluar, u bo tërësisht në kohë t'caktuar i ndaluar. Dhe pika kulminante e t'gjitha këtyre ngjarjeve është arritë, shikuar nga këndvështrimi im, në dhjetor '89-tës, janar- shkurt '90-tës. Ishin ngjarje shumë intensive, ishin në janar

veçanërisht protesta masive në gjithë Kosovën, në gjithë Kosovën pa përjashtim. Dhe mendoj, në gjithë Kosovën, jo vetëm gjeografikisht, por edhe për nga pjesëmarrja, për nga mosha, për nga gjinia, për nga pasojat pastaj, ishte gjithë populli pothuajse i përfshirë.

Dhe, në Pejë, si në shumë vende tjera ishte... kishte ditë për ditë protesta, demonstrata në të cilat shumë prej shokëve të mijë të njofshëm edhe... janë lëndu, janë plagosë, janë vra. Në Pejë ka qenë Fatmiri një djalë i ri që është vra në demonstratë, ka qenë fare afër, rastësisht, ka qenë fare afër nesh, nesh mendoj një grup i shokëve dhe shoqeve tona. Me fjalë tjera, aty ku njerëzit vriten, thotë një fjalë dikun e kam dëgjuar ose e kam lexuar, “Lufta nuk matet me një ose dy të vrarë”. Aty ku vritet njeriu është rastësi që vritet noshta veç një ose vriten një qind, ose vriten ma shumë, e kam edhe tash emocione. E kam atë ditë, ndoshta është e paharruar për faktin se në durë tona vdiq një djalë shumë i ri, edhe ne e përjetumë vrasjen e tij, vdekjen e tij, ai vdiq dha shpirt në duart tona.

Edhe pastaj demonstratat ishin... të nesërmen dhe të pasnesërmen edhe një ditë prej ditëve, brenda kësaj jave, brenda këtyre ditëve, ditë të janarit pra, ishte në... tërheqje e sipër nga një sulm bukur i vështirë i policisë, i ushtrisë pastaj doli edhe ushtria në rrugë. Në një kënd, erdhi një burrë, i cili tha që thjeshtë ka dëshirë me bisedu me mua, ka t’bëjë me mospjesëmarrjen ose frikën që kishte ai për pjesëmarrjen e t’gjithë të afërmit që ishte n’gjak në këtë demonstratë, dhe dëshirën që ai kishte për t’mos marrë pjesë. Dëshirën, n’atë kuptim frikën që kishte ai që mund të ndodhte diçka në demonstratë dhe ai i kishte thanë kushërijëve të tij se ma mirë ishte t’mos dilte në demonstratë. Domethanë ishte një... një frikë reale e tij edhe pse, sinqerisht, në moment nuk kam menduar që n’ato rrethana mundet dikush me dalë në demonstratë ku ne vriteshim nga regjimi, dhe mund të vrasë dikush dikënd. Mirëpo, ka gjasa, unë kam qenë më shumë idealiste, kam besuar në këtë gjë, ai ka qenë më pak idealist, noshta më shumë realist, po e thomë tash nga kjo distancë kohore. Mundësitë nuk ishin, se ne ishim në tërheqje e sipër, lëvizja ishte shumë e kufizuar dhe mbetë me kaq. Ai shprehu shqetësimin e tij dhe u shpërndamë.

Pas kësaj demonstrate, unë nuk u ktheva në fshatin tim në Raushiq tek baba dhe nana sepse ashtu kështu ne ishim pak a shumë të dalluar për faktin se kishim qenë të burgosur politik ma përpara. Dhe unë kam shku tek gjyshi dhe gjyshja [që] kanë jetu vetëm në fshatin Strellc, domethënë nga ana e nanës, gjyshi dhe gjyshja. Dhe dikur në mbrëmje vonë, erdhi baba im me këtë burrin që e përmenda, një burrë nga Bërliqi, i cili erdhi dhe shprehi edhe një herë shqetësimin e tij, frikën e tij. Dhe njëkohësisht ai e bëri një lutje duke e besuar që rrethi i tij familjar, pra edhe këta njerëzit që ishin n’konflikt kanë respekt për mua si e burgosur politik, për neve si ish-t’burgosur politik. Edhe ai besonte shumë që ne mund të ndërmjetësonim n’mes të këtyre dy familjeve për aq kohë sa ishte vështirë, situata e vështirë politike, respektivisht kishte protesta e demonstrata.

Erëmirë Krasniqi: A kërkojke ai prej juve, ju me marrë besë për to...?

Hava Shala: Po, ai mendoi thjeshtë me marrë besë, po. Ai kërkoi thjeshtë me ndërmjetësu, me marrë besë që mos me qenë njerëzit të rrezikuar dhe mos me ndodhë një vrasje mes tyre, një hakmarrje. Po e thomë sinqerisht, diçka unë isha hala shumë e bindur që diçka e tillë nuk mund të ndodhë, kisha

shumë besim të madh që nuk ka njeri n'atë kohë që mundet me dalë me marrë hak ose me vra dikun në demonstrata për shkaqe të tilla. Une nuk i thashë atij që nuk do t'boj kurgjë, i dhashë fjalën që do t'takohem me shokë dhe do ta bisedoj këtë mundësi. Po e kisha ma shumë sa për t'ia bërë qejfin për momentin, sepse vetë nuk isha hala e bindur që mund të jetë ashtu. Pastaj shkunë ata edhe atij i mjaftoi ajo.

Sigurisht unë do t'kisha bërë diçka, por ablsolutisht jo, në masën që ndodhi me t'vërtetë pastaj. Pasi ata shkuan, unë shikova lajmet edhe nuk m'kujtohet, ndoshta me e kthy mendjen mrapa e gjej edhe kohën edhe datën edhe ditën, por sikur hala s'iu kom hy detaleve dhe ndoshta nuk do t'ju hyjë unë personalisht ndonjëherë. Dhe në lajme doli zëdhënësi i qeverisë së Millosheviqit n'atë kohë, qat' kohë e kam ditë emrin, por e kam problem shumë me i mbajtë n'mend emrat. Edhe tha që, "Nuk u vranë..." Në Pejë, në Deçan u vra dikush, në vende t'ndryshme të Kosovës kishte të vranë. Dhe tha, "Nuk u vranë nga ushtria dhe policia jonë," e tyre, "por u vranë shqiptarët primitivë për shkak të gjakmarrjes". Ajo... nëse e shikon ndonjëri, unë jam e sigurtë që ajo gjindet dhe ka një njerëz që e kanë ndëgju atë deklaratë.

Edhe ajo ka qenë një koincidence mes ardhjes së këtij burrit që për fat t'keq nuk ia di emrin nga Bërliqi me shqetësimet e tij, dhe lajmet, dhe akuzat... respektivisht alibija që ky person i krijonte regjimit t'vetë në këtë mënyrë. Ishte shumë irrituse, ishte shumë e papranushme për mua, ishte shumë diskriminuse, ishte shumë e pavërtetë, ishte shumë jo-njerëzore. Edhe, në atë moment për mu ka qenë e qartë pastaj, që e para gjë që do t'bëjë të nesërmen, pa marrë parasysh rrezikun që mund ta kisha të nesërmen për t'dalë në qytet në Pejë, unë kam qenë e prerë, kam qenë e vendosur, kam qenë e bindur, thellë e bindur që duhet t'bëhet diçka në këtë drejtim. Ka qenë për mu plotësisht e papranuar kjo mshefje, kjo alibi idiotike e regjimit të Milloshit n'atë kohë për krimet që i bante.

Dhe, të nesërmen kam dalë në Pejë. Personi i parë që kam dashtë me taku e që jam nisë për ta takuar, ka qenë Myrvetja, atëhere është qujtë Myrvete Dreshaj, Myrvete Dreshaj Baliu sot pasi është martuar. E kam takuar në Pejë edhe, edhe kemi fillue me bisedu, mu m'kujtohet nëse ajo i ka dëgjuar lajmet, apo jo. Me Myrveten jemi kuptu gjithmonë shumë mirë, kemi qenë shoqe ma përpara, para burgut, gjatë burgut, pas burgut. Dhe jemi kuptu, nuk osht' dashtë shumë me shpjegu, nuk osht' dashtë me ia mbushë mendjen... ajo e ka konsideruar shumë të rëndësishme dhe ka thanë që, "Do t'shohim se çka mund të bëjmë". Tamam në këtë bisedë në Pejë, vijnë rastësisht Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Ethem, rastësisht për momentin se ata kishin një detyrë. Ata kishin dalë për t'bërë diçka, e mos gabofsha për t'shpërnda pamflete të ndryshme. Ose diçka... m'baj n'mend që kishin diçka shkresa në dorë, po nuk e diskutumë atë fare sepse ishte menjëherë tema për t'cilën veç kisha folë, ose ishim duke bisedu me Myrveten. Edhe ata e dëgjunë mendimin tonë dhe thanë, "Patjetër. Është koha, është rendi, edhe ne mendojmë, patjetër!" Ishte menjëherë e vetëkuptushme.

Dhe për shkak se lëvizja në Pejë ishte ashtu kështu e rrezikshme, po ne pak a shumë ishim msu me rreziqet si t'thushë edhe... vendosëm me shku dikun që ishte e mundur, ishte afër dhe tek dikush që ishte natyrisht, mund të ishte përkrahës i joni. Dhe ai dikush ishte Adem Grabovci, që ishte për mua hala i panjohur, domethënë unë nuk e kisha njoftë Ademin ma përpara, si emër po, por jo

drejtpërdrejtë. Edhe Brahimi, Luli, Myrvetja dhe unë kemi shkuar tek Ademi atë ditë në shtëpinë e tij, dhe kemi biseduar dhe padyshim jemi dakorduar. Domethanë, nuk është dashtë shumë me diskutu, nuk është dashtë shumë me filozofu. E vetmja gjë që neve na ka preokopu atë ditë, ka qenë fakti se lëvizja veç e jona pa një lloj diskrecioni, pa një lloj mbulese si t'thushë, do t'ishite rrezik të dështojë që në fillim aksioni. Aksioni si aksion, si veprim, ne ishim të bindur si ide, është plotësisht ide e duhur, është në kohën e duhur, është përgjigje e duhur akuzave të bëra një natë ma përpara. Mirëpo, ne menduam se na duhet një përkrahje qoftë edhe për shkak t'një performancës që krijon, na jep neve mundësinë me qenë pak ma diskret, mos m'u konfrontu direkt me policinë, e ushtrinë, me regjimin e asaj kohe.

Dhe idea ishte pastaj, të pysisim intelektualët, t'i kontaktojmë ato edhe kemi pytë kryetarin e Lidhjes Demokratike, atëhere Imer, profesor, Imer Muhaxhiri edhe përgjigja e tij ka qenë, "Idea është e mirë, gjithësesi padyshim, por ne jemi në fillim të organizimit dhe kemi frikë se mund të jetë vështirë për Partinë" politike të tyre. Dhe më pastaj kemi menduar që një person, një ftyrë e nderuar, e çmuar, e vlerësuar që ka edhe kompetencën e hyrjes në oda, bisedës në odë, ishte profesor Zekeria Cana dhe profesor Anton Çetta, respektivisht s'pari Zekeria Cana. Ishte i nderuar, të paktën dhe tek ne, por jo veç tek ne po ne e njëfishim angazhimet e tij, literaturën e tij. Dhe kemi shkuar pastaj tek profesor Zekeria Cana dhe ai ka qenë shumë impulsiv ashtu qysh e njohim ne n'atë kohë. Ka qenë i gjallë, jo i komplikuar, ka qenë i komplikuar në mënyrën e tij sikur t'gjithë njerëzit (buzëqeshë). Shpesh herë i komplikuar ka qenë për faktin se ka qenë edhe i guximshëm edhe neve na duheshte pak diskrecion pak, por megjithatë ai ishte personi që ne e kishim përzgjedhë. Sigurisht nuk ka qenë gabim fare. Ai thotë që, "Personi i duhur jam unë patjetër, po një person hala ma i duhur, hala më i përshtatshëm do t'ishite profesor Anton Çetta".

Pastaj kemi shkuar te profesor Antoni dhe e kemi biseduar. Natyrisht, ata e kanë konsideruar ide të mrekullueshme, ishte veç një ide, ishte një... ishte një përkrahje e padyshimtë nga gjithë njerëzit me t'cilët kemi biseduar. Por, ishte dilema si t'ia bëjmë konkretisht sepse ne s'kishim dyshim që idea është e duhur, në kohën e duhur.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e keni konkretizuar këtë ide...?

Hava Shala: Ne veç kishim, kishim... unë i pata dhanë atij burrit nga Rrafshi... nga Bërliqi fjalën që do t'bëj diçka. Dhe në një mënyrë isha e obligushme që nëse duhet dikun të startohet, do t'ishite ky rast. Dhe jo rastësisht pra filloi në Lumbardh të Deçanit, sepse familja e hasmuar, njëra prej... familja që iu ishte vlarë njëri i familjes, ishte familja në Lumbardh, familja Leka në Lumbardh. Neve u organizumë pastaj, pas bisedës me këta dy profesorë edhe me persona të tjerë pastaj. Më vonë ka qenë i konsultuar edhe profesor Rexhep Qosja, kanë qenë edhe profesorë tjerë universitarë, kanë qenë edhe intelektualë tjerë. Rrethi ma tutje është zgjeruar n'proporcion gjeometrik si t'thushë, secili ka bërë diçka n'këtë drejtim. Dhe, ne e caktuam ditën, jam bukur shumë e bindur që ka qenë 2 shkurti. Ka njerëz që thonë ka qenë 8 shkurti. Për fat t'keq ne nuk kemi mbajtur atë kohë shënime sepse vetë kemi qenë në lëvizje. Pastaj ka qenë rrezik nëse zihesh e kontrollohesh e gjindet diçka, merret pastaj... problemi merr dimensione shumë ma të vështira. Dhe qëllimi jonë ishte që aksioni mos me u ndalë.

Dhe mund t'jetë 2 shkurti, për mua është 2 shkurti, por nuk ka edhe aq shumë rëndësi, ndoshta për historinë ka rëndësi, për mua ka ma pak rëndësi. Kemi shku e kemi orgainzu, disa shokë 90 përqind kanë qenë të burgosur politik, dhe dashamirë të kësaj ideje dhe dashamirë tonë që na kanë ardhë me vetura, kanë ardhë me mjetet e tyre, kombi. Domethënë kishim një traktor, ishte një ofertë me marrë me vete (qeshë), se ishim shumë veta. Edhe kemi shkuar atë ditë me profesor Anton Çettën dhe Zekeria Canën dhe dikund 17-18 vetë, 20 vetë është e mundur që kanë qenë. Dhe kemi udhëtuar ashtu të mobilizuar në këtë mënyrë tonë. Kemi udhëtuar për Lumbardh të Deçanit. Kam dëgjuar gjithmonë ide të ndryshme. Njerëzit që e kanë pasë me të dëgjuar, ka fillu nga rinia e Deçanit, ka filluar nga rinia e Pejës, ka filluar... mu nuk m'kanë pëlqyer këto kufizime, këto lokalizime. Kanë filluar nga... rastësisht kemi qenë ne, ka mujtë me qenë dikush tjetër, por në këtë grup kanë qenë njerëz të rretheve të ndryshme, të moshave të ndryshme, t'gjinive të ndryshme. Vajza kemi qenë pak por megjithatë kemi qenë, edhe kemi shkuar në Lumbardh. Jemi pritë mirë, sipas traditës është hapë oda, jemi ulë të gjithë.

Erëmirë Krasniqi: Çka ka qenë rasti i Lumbardhit?

Hava Shala: Lumbardhi ka qenë një vrasje. Domethënë, shkaqet ne asnjherë nuk i kemi hulumtuar por mesa e di une, ka pasë diçka t'bëjë për tokën ose për ujin ose diçka me... tokën e përbashkët. Nuk jam e sigurtë për faktin se ne asnjherë nuk iu kemi kthyer rastin si tërësi, sepse s'kemi dashtë me i dhanë vetes të drejtën e gjykatësve. Ne kemi bërë një thirrje në emër të interesit t'popullit, në emër t'ardhmes tonë. Në emër të rinisë, në emër të perspektivës të rinisë, të falet diçka jo të gjykohet. Ne nuk e kemi diskutu asnjherë dhe nuk e kemi vnu asnjherë n'pytje faktin se krimi është krim, vrasja është vrasje. Për neve ka qenë shumë e qartë që aty është vrarë një njeri, dhe pa diskutim aty është bërë një krim. Kanë qenë pastaj rrethanat që e kanë lehtësu apo e kanë rëndu rastin, ne nuk kemi hyrë në ato gjëra sepse aty do t'kishim një rol tjetër fare.

Ne e kemi pasë t'qartë për çfarë arsye kërkojmë një falje gjaku, për t'cilat interesa. Për këtë arsye nuk kemi hy shumë, ka qenë rrezik pastaj njerëzit të idhnohen, të emocionohen, të ngriten gjakërat prapë dhe të kthehesh në pikën zero. Për këtë arsye e di që është vrarë dikush i kësaj familjes, por për çka tamam, e di që ka qenë toka diçka n'pytje, por detalet nuk i di. Pas shumë bisedave, pas shumë kohësh, një bisedë relativisht kaotike, kaotike për faktin se secili prej nesh thoshte diçka me rradhë me qëllim të mirë gjithësesi. Me rradhë, pa rradhë, sipas mendimit tonë, ne kemi dhonë një përgjigje, ose kemi shtrur një pyetje dhe ka qenë për pritësin, për pritësin ka qenë një ngarkesë shumë e madhe. Por edhe për neve pastaj ka qenë, ne e kemi kriju përvojën e parë në atë odë. Kemi shku me një ide të mrekullushme, kemi shku me një qëllim shumë njerëzor, shumë human, shumë atdhetar, por ne nuk e kemi ditë se si do t'bëhet më s'miri. Mirëpo, ne kemi kriju atë ditë një përvojë shumë t'rëndësishme, ne kemi parë se të shkosh në mënyrë kolektive është një trysni ndoshta, është një stres i madh, është një bisedë pa rradhë, është... tjetri ndihet i vetmuar përballë gjithë këtyre njerëzve. Ndoshta nuk merret gjendja e atij emocionale parasysh. Thjeshtë ishte për neve e qartë në këtë mënyrë nuk do t'duheshim kështu të shkonim.

Dhe për këtë arsye, gradualisht kemi filluar të mendojmë që puna përgatitja në odë, në oda të burrave,

brenda familjes të bëhet nga grupe t'caktuara të punës, njerëz të përzgjedhur që dijnë të bisedojnë, që dijnë të flasin, t'mos e lëndojnë tjetrin, por as nuk lëshohen në rrafshin e ulët si t'thushë të problemit. Rrafshi i ulët mendoj, “e ka pasë keq, e ka pasë mirë” pa e diskutu. Thjeshtë ne jemi nisë nga ajo, ne jemi në ni rrafsh tjetër, është rrafshi njerëzor, është rrafshi human, është rrafshi atdhetar. Nuk kemi guxu me lujtë. Edhe është dashtë me i përzgjedhë njerëzit, sepse ka pasë raste për shembull kur njeriu ka shkuar dhe ka bërë një llapsus edhe kemi dëgjuar për shembull, një filan personi i një grupit t'caktuar është përzanë nga oda e burrave. Edhe ne kemi hulumtu pak rastin, e kemi shiku edhe ne kemi kuptuar se grupi i caktuar edhe personi i caktuar në atë grup ka qenë relativisht dominant, relativisht diktues. Faktikisht, s'mund t'shkosh atë kohë dhe asnjëherë në shtëpinë e atij që ka humbë njerinë e t'i thushë, “Duhesh ta bësh!” Nuk shkon me “duhet”. Edhe për këtë arsye ka qenë shumë e rëndësishme pastaj edhe përzgjedhja e njerëzve, njerëz që kanë pasë edhe një kredo morale, kanë pasë edhe një të drejtë morale me pasë pritje të caktuara. Po, duke e ditë gjithmonë përmes bisedës, përmes fjalës me e prekë pikën më t'ndishme të asaj kohe.

Unë dhe liria e këtij vendi, liria e këtij vendi fillon me mua, edhe unë do t'bëj diçka edhe unë mund t'bëj diçka për t'ardhmen e këtij vendi, sepse të gjithë jemi n'rrezik. Pak a shumë kjo ka qenë motoja, motoja e imja dhe jo vetëm e imja. Kurse, motoja tjetër ka qenë të falen... secili në mënyrë të veten e ka definuar një moto të parën, ka gjaqe për kaq të vrarë 40, gjaqe për 40 të vrarë, ose aq aq. Për neve, për mua personalisht nuk ka qenë një aksion me kufizime, nuk ka qenë... qoftë n'aspektin kohor, e kemi menduar një vit, po nuk ka qenë absolute. Nuk kemi thanë kaq dhe aq, por n'fund t'fundit secili njeri ka pasë të drejtën me thanë diçka edhe nga vetëvetja. Nuk jemi marrë me anën politike të... e ka pasë sigurisht një dimension politik, por nuk jemi lëshu në atë se kush ka të drejtë, kush s'ka të drejtë. Jemi munduar nëse ka pasë ndonji gabim, njonjë rrëshqitje për nga pakujdesia, atëhere e kemi biseduar, e kemi këshilluar. Pastaj kemi qenë, kemi qenë në Raushiq, në Raushiq është një vajzë që është vrarë. Ka qenë një herë dy familje, familja Mulliqi që ka pasë reciprokisht të vrarë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh u prit Lëvizja e Pajtimit...

Hava Shala: Dhe...

Erëmirë Krasniqi: A kish hezitim?

Hava Shala: Njerëzit kanë thanë, kanë dëgju, kanë thanë, “Në odë, studentat e rinjë, vajzat!” Ka qenë e pa marrë me mend, është dashtë ndoshta një vetëbesim bukur i çmendur me hy n'odën e burrave. Është dashur ta njohësh odën e burrave, është dashur ta njohësh atë, të mos e lëndosh, dhe njëkohësisht ta kapërcesh atë, ta bartësh vetë burrin e odës pak me vete, ta nxerrësh, t'i thushë bota është ma e gjerë, dhe burrnia ka shumë ma shumë hapësirë. Është pritë si ide, padyshim, mirëpo kanë qenë, njerëzit skeptikë kanë qenë, nga frika se mund t'mos t'jetë shumë reale, mund t'mos jetë e realizushme. Mirëpo, njerëzit kanë qenë si ide, kanë qenë të fascionuar, rezistencë, ose mos përkrahje, ne nuk kemi parë, nuk kemi parë. Unë nuk kam takuar dikë që ka thënë, “Lejeni këtë punë!” Ndoshta është dëgjuar grupe të caktuara që kanë pasë interesa për ndërmjetësim të... me dhjetëra vite që i kanë mushë xhepat, i kanë mushë kuletat me para. Por kështu drejtpërdrejtë edhe nuk mund t'thomë se ka

qenë e shtrirë ajo rezistencë, por dëgjuar aty-këtu nga ndonjë interesgji të cilën e kam potencuar që n'atë kuptim, "Burrat me musteqe edhe s'kanë mujtë me pajtu këtë gjak e... deri më t'rinjë".

Por, aksioni u shtri shumë shpejtë. Vetë fakti se u zgjeru kaq shpejtë, u përqaftu si ide, edhe u bashkangjiti njerëzit në veprim, e bëri që relativisht shpejtë me u pajtu gjaku në Raushiq, ku ni kontribut shumë t'madh e ka dhanë profesor i imi i Gjuhës.... Memoria ime më është plakë, do t'kujtohem ma vonë, m'vjen keq tash nuk... është një tmerr se si është shly memoria ime, respektivisht emrat nga memoria ime... Nimon Alimusaj. M'vjen keq që e nxorrra, se kam pasë respekt për të, ka qenë profesor i imi i nderuar i Gjuhës Shqipe në gjimnaz. Dhe pastaj, një pajtim i gjakut n'familje ku ishte vra një vajzë, pastaj pajtimi i gjakut në Bërliq, që është në fakt pajtimi i parë i plotë gjakut ku është falë një person i humbur i vrarë i një familjes është falë plotësisht. Domethonë te Mulliqët kanë qenë vrasje reciproke por është ndërpre gjakmarrja e matutjeshme, kurse tamam falja e gjakut tipike si t'thushë ka qenë në Raushiq.

Ndoshta unë për veten time iu kam ikë rasteve. Njerëzit zakonisht i kanë lokalizuar rastet për t'thënë, "Unë dhe ky rast", "Unë dhe ai rast". Unë tmerrohem nga fakti se do t'duheshe, do t'duheshte një ditë me m'lanë mendja me thanë, "Unë dhe ky rast", sepse kanë qenë procese aq të dhëmbshme shpirtërore, prej momentit kur kemi fillu bisedën, dej tek falja e gjakut. Sa është shumë idiotike me thanë, "Unë jam meritore për atë". Është... për mendjen time, për shpirtin tim, për mua tërësisht është shumë egoiste me thanë, "Unë dhe ky rast", "Unë dhe kjo". Jo rrallë kam dëgjuar versione të ndryshme, tregime të ndryshme, përralla të ndryshme, njerëzit m'kanë thanë, "Pse nuk del?" "Pse nuk thua?" E kam pasë shumë t'vështirë, pikërisht pse kam pasë frikë që mos t'kuptohem nga njerëzit që kanë dhënë kaq shumë nga vetja sikur unë do t'thomë, "Ti nuk po e thu t'vërtetën, unë jam ajo që kam qenë". Dhe unë e kam këtë problem. Po... sepse është, ata e kanë bërë, ne e kemi pasë idenë, ne e kemi marrë kohën, ama ka qenë proces shumë i dhunshëm, ka qenë shumë proces i tmerrshëm nganjëherë.

Ka qenë... sikur t'kish qenë n'pyetje veç drejtësia, shpesh herë i kam shtruar vetes pyetjen, "A është edhe n'rregull gjithë kjo dhembje?" Ne nuk kemi gux me hy shumë thellë në rrafshet tjera njerëzore, jemi kapë te rrafshi më i lartë, n'atë kohë, ka qenë edhe metet gjithmonë atdheu, sakrifica për atdheun, për t'ardhmen e fëmijëve tanë, për t'ardhmen tonë përgjithësisht. Përndryshe, duhesh me qenë tepër egoiste ose egoist, për me thanë që, "Ne e kemi bërë hyzmetin tonë popullor" që, ne kemi marrë kohë, por ata e kanë bërë faljen e gjakut dhe ata kanë qenë t'bindur që ajo falje e gjakut bëhet për interesa të atdheut.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka funksionu Lëvizja?

Hava Shala: Pastaj, në rrethin e Pejës u krijunë grupet e punës, fillimisht tri grupe t'punës, pastaj secili me kontributin e vetë, krijonte një grup tjetër të punës. Dhe u shtri relativisht shpejtë, dhe u qartësu. Grupet e punës e përgatitën faljen dhe faljet bëhen pastaj, pjesëmarrja e njerëzve t'thjeshtë bëhet tek në ceremoninë e shtrirjes së dorës. Në fakt kur janë mbledhë pastaj njerëzit, rasti ka qenë praktikisht i falur. Është dashtë vetëm për respektin e njërit që ka falë gjakun, është dashur me marrë faljen, figurativisht me thanë. Dhe prej marrjes së dorës besës, faljes së gjakut, grupi i punës ka pasë obligim

për t'shkuar te familja e vrasësit, për t'ia çu porosinë, faljen, dhe njikohësisht për ta këshilluar, për t'pasë qëndrim korrekt, për t'mos provokuar, për t'mos qenë krenar përballë atij tjetrit, thjeshtë me e njoftë atë falje si një akt human, njerëzor, atdhetar, akt i cili do ta obligonte edhe familjen tjetër me qenë shumë i arsyeshëm në sjellje në fshat, në lagje e kështu me rradhë.

Pjesa e Katërt

[Video intervista është prerë]

Pastaj, grupi jonë kemi shkuar në... grupi jonë mendoj, ne grupi me Myrveten, me Ademin, me Brahimin me Lulin, ka qenë ai grupi bazë si t'thushë. Jemi... kemi marrë detyra t'caktuara dhe jemi shtri nëpër territore tjera të Kosovës. Dhe ne grupi i vogël i fillestarëve, kemi shku në Rahovec n'atë kohë, kemi takuar njerëz, natyrisht kanë qenë personat e parë që i kemi takuar në rrethet tona derisa nuk është bërë përfshirja gjithëpopullore. N'aksion kanë qenë kryesisht shokët e familjet e ish të burgosurve politik, dhe pse ki pasë besim edhe para-kusht i rëndësishëm ka qenë besimi tek njeriu. Dhe më pastaj prej aty kemi aktivizu shokë të tjerë, dhe mbaj n'mend që ka qenë Rahoveci pastaj stacioni tjetër ka qenë rrethi i Prizrenit gjithashtu. Është shtrirë pastaj në Drenicë, në Kosovë, është bashkangjitë Akilja, ka qenë një person i rëndësishëm për rrethin e Fushë Kosovës, rrethin e Prishtinës, ka qenë Rrahman Dini. Ka qenë... intelektualë me shumicë, duhet me bë noshta një listë të tërë, t'njerëzve që me vetëdije janë angazhu janë... kanë lëvizë dhe relativisht shpejtë, është rritë numri... është bërë një numër shumë i madh i pjesëmarrësve. Dhe nuk ka qenë idea si e tillë, nuk ka qenë më e rrezikuar sepse u shtri mjaft dhe ne vazhduam pastaj këtë principin, grupet e punës, përgatitjen e faljet t'gjakut, falja e gjakut në një ceremoni, dhe këto ceremoni u banë pastaj një lloj... një lloj takimi ku njerëzit edhe pa e bo përgatitjen për faljen e gjakut, vinin dhe e falnin gjakun.

Dhe, kulmi i këtij takimi ka qenë takimi me 1 maj tek Verrat e Llukës ku me siguri, më të drejtë thuhet se kanë qenë gjysë milioni njerëz. Dhe ne... numri i gjaqeve të falura atë ditë i planifikuar ka qenë shumë më i vogël sesa numri i gjaqeve që janë falë pastaj. Ku njerëzit kanë filluar të ndihen moralisht të obliguar t'bëjnë diçka edhe ka qenë një festë e jashtëzakonshme ku e kujtoj që asnjëherë njeriun e Kosovës ma të bindur për vetëveten, për forcat e veta, se atë ditë nuk e kam parë, nuk e kam përjetuar, ni se kemi qenë t'rrethuar me ushtri, me polici, me pancera, gjithë ajo hapësirë. Rreziku ka qenë shumë i madh me eskalu, po njerëzit kanë qenë aq të diciplinuuar si kurrë më parë, aq të sigurtë në vetëvete si kurrë më parë, aq të denjë për faljen e gjakut si kurrë më parë. Është një moment që unë nuk e harroj, dhe natyrisht nuk është i vetmi moment, po është kulmi i këtyre ceremonive si t'thushë madhështore të faljes së gjakut.

Erëmirë Krasniqi: Cka ishin fjalimet që i shkrujshit, edhe rreth cilave tema ishin?

Hava Shala: Unë do t'them diçka, e kam thënë edhe herave tjera edhe tashi do them diçka, ne... ish të burgosurit politik kemi udhëtu gjithmonë, kemi udhëtuar me një pasiguri t'vogël se nëse dalim, do t'kthehemi prapë te shpia, ose do t'kthehemi prapë aty ku jemi nisë. Për neve s'kemi qenë t'sigurtë që

nuk mund t'arrestohem në rrugë e sipër, prandaj është dashtë gjithmonë t'kemi kujdes, mos t'bajmë gjëra me vete, shënime veçanërisht, sepse gjithmonë kish qenë një arsye pastaj për t'u ngarkuar gjendja jonë nëse do t'arrestoheshim. Dhe për këtë arsye, më vie keq, por fatkeqësisht unë nuk kam pasë mundësinë dhe disa shokë e shoqe tona të mbajmë të dhëna t'sakta për këtë. Por e di relativisht saktë se si ka qenë puna natyrisht.

Ne kemi... fillimisht i kemi organizu këto ceremoni në mënyrë të planifikuar, për shembull në Rugovë, në Rugovë të Hasit, në vende t'ndryshme për t'mos i numruar i kemi planifikuar se ka qenë qëllimi jonë me i sensibilizu popullin, njikohësisht me lëvizë pak a shumë botën e brendshme të njeriut n'atë kohë. Edhe më pastaj ato ceremoni janë bërë si një apel, si një log ku njerëzit kanë tregu burrninë e tyre. Për shembull, tek Verat e Llukës ka qenë e planifikuar, kanë qenë rastet e caktuara të cilat i kemi përgatitë. Kanë qenë thirrjet, kanë qenë gojore në fakt, edhe s'kemi bërë kurrëfar thirrje me shkrim, por njerëzit kanë ardhë, kanë ardhë me gra, me burra, me pleqë, me plaka, me t'rijë, me fëmijë, me familje. E pabesushme, e pabesushme!

Unë kujtoj që edhe një civilizim të një shkallës t'lartë e ka sjellë aksionin me vete. Ka shumë dimensione dhe sigurisht njerëzit e ndryshëm kanë folë edhe për aspektet e dimensionet e ndryshme t'aksionit, po unë kujtoj që aty njeriu i odës, aty gruaja e shtëpisë, aty... është kapërcy vetë kufiri i jonë, vetë kufiri mendoj, burrat i kanë vnu vetes një kufi bukur të vështirë në odën me burra. Gratë e kanë pasë një kufi që me kohën... i jap vetes të drejtë me qijtë edhe një vetëkufizimi, gruaja e parë e ka konsideru normale mbetjen në shpi. Dhe njeriu që rrin vazhdimisht në shpi, nuk beson ma në forca t'veta që mund ta çojë ma përpara. Ato gra, ato burra, ata njerëz dulën nga oda, dulën nga shpia, panë, dëgjunë, e panë një forcë madhështore që njeriu mund ta kapërcejë vetëveten, dhe natyrisht se mund ta kapërcejë edhe kufirin e armikut patjetër pastaj. Dhe kjo forcë, ky emancipim mbetet në kujtesën time dhe sigurisht mbetet në kujtesën e popullit.

Shpesh herë pastaj në kohën e luftës kur i kam parë gratë në televizor ose... gjatë përkthimeve të ndryshme, kur kam përkthyer për gratë që kanë ardhë vetëm me fëmijë nëpër bjeshkë, nëpër... fusha të minuara ndoshta, nëpër zona të vështira. Por kanë ardhë dhe kanë qenë të vendosura, kam thanë, ndoshta ka qenë një sprovë n'atë kohë, sikur gratë e kanë provu tek vetja forcën të cilën më pastaj e kanë realizu si t'thushë, e kanë pasë me vete në kohën e luftës. Kujtoj, ka qenë një lloj provimi si t'thushë i vetëvetes.

Ndoshta, është e rëndësishme në këtë pikë, me thanë diçka, diçka të veçantë. Në kohën kur duke hyrë në odën e burrave, burrat aty-këtu e kanë pa se ajo bota pak a shumë e gurëzuar e odës, ka fillu me lëvizë. Dhe jo rrallë kur ka ardhë fare afër tek marrja e një "Po-je", që do të falet gjaku, sikur ka qenë një frikë ndoshta nga burrat, që po e humbin atë rendin e odës së burrave, sikur, sikur ka qenë një lloj edhe me lëvizë ka njeriu një lloj frike, nuk din se çka po bëhet ma tutje. Me fjalë tjera, ka pasë raste kur burrat kanë thanë, "E shofim deri javën e ardhshme". Për shembull, një rast në Isniq tha, "Pothuajse u bo pajtimi", ose "U dha fjala për t'u pajtu". Dhe burrat kanë thanë pastaj, burrat e odës që, "Ne edhe po ta falim është e mundur që gruaja e të vrarit dhe fëmijë e tij munden mos me qenë dakord edhe munden me thy fjalën tonë, besën tonë". Edhe, mbaj n'mend që kam qenë ulur afër Myrvetes dhe... also [pra]

me fjalë tjera, mes Myrvetes dhe profesor Anton Çettës dhe unë i thomë profesor Antonit pakës me një zë t'ulur se, "A do t'guxonim unë dhe Myrvetja me shku tek gruja, nëse osht' kaq e rëndësishme për kta?" Edhe për neve ishte gjithësesi e rëndësishme, po kishte fillu burrat për herë t'parë me bo një lloj shmangie nga rendi i odës dhe nuk e dijsim se sa është frikë e burrave që po dalin a odës, sa është një pretekst për t'mos e thënë fjalën e fundit pozitive. Dhe ai thotë, "Burra, ne e kemi dy burrneshë, i kemi sy studente" siç ka ditë profesor Antoni ma s'miri me e thanë. Thotë, "Ne kishim dashtë për juve me iu lehtësu, kishim dashtë me i çu këto me bisedu me gratë që ju mos me pasë atë barrë me gruan e të vrarit".

Dhe ne shkumë për herë t'parë, shkuam... ishte hala para takimit tek Verat e Llukës. Dhe shkuam ne tek gruja, dhe ajo vjehrra silleshte, ishte e shqetësuar, ishte nana n'fund t'fundit e djalit që e kishte humbë, edhe ne e lutëm pastaj ate. I thashë që, "Ne na kanë çu burrat", në fakt bëmë një lëvizje fjalësh se burrat nuk na kishin çu me bisedu veç me gruan, e me përjashtu vjehrrën nga biseda se si kish qenë fare biseda ashtu e detalizuar. Po ne i thamë që na duhet me bisedu vetëm për vetëm. Sigurisht asaj nuk i ka ardhë shumë mirë, po nuk tha diçka, ishte e sjellshme dhe ne mbetëm vetëm për vetëm. Dhe ne e konfrontuam gruan.

Erëmirë Krasniqi: Çka i thatë?

Hava Shala: Ne i thamë që burrat janë dakord, ata janë të shqetësuar se ti mundesh mos me qenë dakord dhe djemtë e tu kur t'rriten munden nëse nana nuk është dakord dhe është gjysmë falje. Edhe ne bëmë pakëz një gjysmë lëvizje me fjalët edhe ajo tha, "Jo, une nuk du fëmive t'mi me iu lanë bela. Fëmija e mi janë të vegjël, nëse burrat kanë thanë ashtu dhe sot po bëhet diçka edhe për t'ardhmen e fëmive" se ne folëm pakëz për një t'ardhme tjetër t'Kosovës dhe t'ardhmen e fëmijëve t'saj dhe gjithë fëmijëve t'Kosovës. Ajo tha, "Atëhere nga ana ime, edhe unë e jap fjalën si burrat atje" (buzëqeshë).

Ne shkuam edhe thamë që ajo ka dhënë fjalën edhe nuk e diskuton përgjigjen e juve, ishte një lloj diplomacie. Edhe mirëpo për çudi ata pastaj nuk e kanë thanë, "Po-në" që ne shpresonim që do ta thonin. Dhe profesor Antoni iu tha që tash kemi një situatë të re, ju lutem mendohuni deri herën e ardhshme, dhe herën e ardhshme shpresojmë që pastaj është një përgjigje burrnore. Dhe herën e ardhshme ata erdhën tek Verat e Llukës dhe e falën gjakun. Një rast kështu për ta ilustruar.

Një rast tjetër për ta ilustruar kur ka qenë n'pyetje roli i gruas dhe kapërcimi i këtij kufirit që ne shpesh herë i kemi vnu vetes ose për shkak të rrethanave sociale, politike janë krijuar statuset e këtilla. Kishim një rast në Morinë, dhe patëm shku me Musën, Musë Berishën njërin prej shokëve tanë të mirë, aksionist i takimit t'parë. Dhe, u dashtë me ecë bukur naltë, atje ishte problem me shku, ama shkumë ne të dytë. Dhe, plaku tha, "Me mua s'mund, s'keni nevojë me bisedu. Unë jam i bindur që duhet me u falë gjaqet, po ai është vëllai i gruas time, unë s'e kam as me Kanun as me ligj të drejtën me e falë ose mos me falë gjakun e vëllaut të gruas. Po gruaja ime është," tha, "në dhomë e saj", m'përcjelli deri aty, tha, "edhe me t'thanë sinqerisht, ajo është sëmure prej se ka marrë vesh që ju keni me ardhë". Edhe unë hyra brenda, edhe ajo ishte vërtetë ishte ratë edhe e lodhur, e mërçitur. Edhe i thomë që kam ardhë, thotë, "Po e di, m'ka thanë edhe vajza", vajzën e kishte mësuse dhe ajo ishte atë ditë në shkollë,

si mësuse punonte.

Dhe, i sjelli pak me fjalë, m'vinte keq, ishte e lodhur, ishte e mërzhitur, ishte ma shumë e sëmure nga mërzhia se sa që ishte e sëmure. Por, e kisha t'qartë se me atë duhesha t'flas ndryshe dhe ajo tha, papritur provoj pakëz me e shmangë bisedën edhe po thotë, "Qysh erdhët rrugës?" tha, "Se kta qafira shumë kujt po ia zojnë pritën" n'atë kuptim, e ia bëjnë rrugën vështirë. Thashë, "Ata bëjnë punën e tyre, ne e bëjmë punën tonë". Ajo tha, "Po. Po, unë e kam vështirë, e kam edhe motrën tjetër, e kemi pasë veç një vëlla t'hastretit e na u ka mshelë", kishin qenë të rrethit t'Deçanit. "E na u ka mshelë gjinia, për ne s'ka gja ma tragjike, ti e din vetë çka domethanë bija pa gjini". Edhe une i thomë, "Po sigurisht e di, prandaj kemi ardhë, tu e ditë që është diçka e vështirë, se për gjërat e lehta sigurisht që s'kish pasë nevojë me ardhë". Po thashë, "Unë du me ta bërë një pyetje edhe du me ma dhanë një përgjigje prej zemrës". Thashë, "Sikur t'ishte sot vëllau yt gjallë, për një moment, sikur t'mundem me ia dhanë shpirtin edhe me bo t'mundshme ai me m'dhanë sot një përgjigje. Dhe do ta pysja sot, a ma me qejf do t'ishte gjaku i tij... a ma me qejf do ta falte gjakun e tij për interesin e t'ardhmes t'këtij vendi, apo do ta lente gjakun e pafalur dhe do t'ishte i pandëruar? Qysh mund t'mbesin sot gjaqet e pafalura e pandëruara?" Edhe ajo... {vnon dorën tek faqja} e mbaj n'mend, u çu rreptë prej shtratit, u ulë në fakt, edhe "Ah," tha, "m'ke zanë ngushtë" tha, "po pasha Zotën, ai ka qenë një trim, një djallë sokol ka qenë". Dhe tash po rrënoqethem kur po e kujtoj atë bisedë. Edhe thotë, "Jam e sigurtë që ai do ta falte gjakun e vetë". Edhe ka mbetë një copë heshtje mes nesh, edhe tha, "Kqyre çika e nanës, hajt shko. Merre atë shokun tand e shkoni te shpija. Une flas me motrën time. Çika ime m'ka thanë, 'Kur t'vij, du me dëgju diçka t'mirë prej teje'", çika e saj, mësusja. Thotë, "Kjo punë osht' e kryme". Edhe ka dalë na ka përcjellë deri tek oborri, është përshëndetë me mua edhe Musën, ajo që ishte shumë e sëmure, papritur i erdhi një forcë (buzëqeshë). Edhe ka ardhë pastaj, çika e saj ka ardhë prej Morinës edhe e ka falë gjakun tek Verat e Llukës.

Ka mjaft e mjaft raste për t'u ilustru, por në këto raste e kam pa se populli ka forcë me i kapërcy këto kufijtë e vetë siç e thashë, të qenurit grua ose të qenurit veç burri i odës ose të qenurit veç burrë, ose të qenurit vajzë. Domethënë, nga të gjitha anët është kapërcy ai vetëkufizimi i popullit edhe u bo një forcë shumë e madhe që i kapërcei pastaj edhe kufijtë gjeografik të Kosovës, kufijtë politik të Kosovës ma mirë me thanë. Është rritë pastaj aksioni edhe në trojet shqiptaret në Maqedoni, edhe në Preshevë e Bujanovc. Ne kemi pasë shokë gjithandej. Edhe në Mal të Zi, edhe atje ka qenë një rast shumë karakteristik i një familjes, jo s'ishte asimiluar por që kishte flamurin në fund të arkës. Secili rast është një rast ilustrues dhe secili rast për të njejtën gjë. Njerëzit e kanë kuptuar, qëllimi është jo personal, jo individual, jo interesi i ngushtë, por është thjeshtë e ardhmja që duhet të ishte patjetër tjetër fare nga ajo që ne përjetonim n'atë kohë.

Erëmirë Krasniqi: Çka u thujke për gjakmarrrjen nëpër oda, që ajo është e... huja, që një kohë është mendu që ose është e hujë, ose na ka mbetë prej...

Hava Shala: Këtë e kanë thanë ma shumë njerëzit që kanë pasë një mendje t'arsimuar, dhe ka qenë mirë që osht' thanë. Por unë t'them sinqerisht, unë nuk e kam dëgjuar prej atyre që kanë qenë brenda problemit, nuk është qurtë gjakmarrrja e huja. Është thanë që gjakmarrrja është e huja, po unë

personalisht nuk mendoj që gjakmarrja është e huja. Gjakmarrja është e huja në kuptimin që janë krijuar shumë rrethana për t'u vra njerëzit n' mes veti. Për shembull, sa toka ka qenë jo mirë e përcaktuar, cila është hisja ime, cila është hisja jote? Pa dyshim regjimi aktual i asaj kohe ka krijuar mjaft rrethana, kam qenë shumë e bindur që kanë qenë, rrethanat kanë qenë shumë armiqësore. Rrethanat janë krijuar kur njeriu pastaj në mungesë të ligjit, në mungesë të drejtësisë, njeriu ka vra veten. Vrasje ka pasë në kohë edhe në Evropën Perëndimore, i kam lexuar pastaj edhe kanunet e ndryshme, edhe në Angli janë vra njerëzit, edhe në Francë janë vra njerëzit, edhe në Gjermani në kohërat e Mesjetës kur nuk kanë funksionu hala ligjet. Sikurse më pastaj ligjet civile në kohën e Evropës t'civilizuar. Domethanë, vrasja ndodhë aty ku mungon drejtësia, aty ku drejtësia nuk është drejtësi, nuk është e barabartë për të dobtin, për të fortin, për të pasurin, për të varfërin.

Mirëpo, është thanë ashtu e ka dashtë koha të thuhet ndoshta. Unë nuk e kam thanë për veten ashtu, une e kam thanë secili jemi të obliguar të bëjmë diçka. Për mu është e dhimbshme pikërisht kjo, duhet të theksohet që ndoshta fakti që ne kemi hy brenda, ndoshta fakti që ne kemi thanë njeriut, "E kuptojmë dhembjen tande, jam plotësisht nën lëkurën tande, jam plotësisht në... e gatshme me hy nën lëkurën tande, edhe pse është e pamundur ndoshta plotësisht me e ndi dhembjen e tjetrit". Ai solidarizimi, ai solidariteti në rrafshin e dhembjes, ka lujtë një rol shumë t'ëndësishëm. Duhet ta them, njeriu është ndi i mirëkuptuar, ti e ki njoftë niherë dhembjen e tij, e ki bartë [atë] njeri me vete, i ke dhanë forcë, e ke ngritë mbi dhembjen dhe i ke thanë, "Dhembja ka kuptim, mund të shërohet, mund të lehtësohet, mund të marrë një kuptim krejt tjetër fare nëse bëjmë diçka kundër vrasjeve t'matutjeshme, dhe unë e kam këtë forcë për ta bërë këtë burrni."

Dhe ajo që ka qenë një moto e rëndësishme është, "Vetëm ata që janë burra, janë të fortë, janë njerëzorë kanë forcë me bo këtë akt kaq madhështor". Jo njerëzit, është thanë me një mënyrë është thanë, jo direkt, është thanë, ata që janë burra, në kuptimin jo të gjinisë mashkullore, po burra në kuptimin e parë t'fjalës së odës burra – njerëz me karakter, njerëz me moral, njerëz me vetëdije t'largë, njerëz me gatishmëri për t'sakifikuar, njerëz atdhetarë, ata i kemi qujtë ne burra. Ata edhe e kanë shtri dorën e pajtimit.

Unë mbaj n'mend njëherë me një vend, nuk du me i dhanë emër fshatit, edhe pse e kam thanë njëherë publikisht. Ne biseduam, biseduam, biseduam, biseduam edhe ai burri tha, "Jo! Nuk e fali!" Edhe profesor Antoni, kurrë nuk e harroj, i tha, "E kuptoj që nuk e fal" edhe ai tha, "Eh pra", n'atë kuptim shyqyr që po m'kupton. Ky i tha, "E kuptoj që nuk mundesh me falë, se duhet burrni shumë e madhe për me falë sot". Edhe ai e mbylli pastaj, nuk e... diskutoi ma tutje, e morri vesh se cila është. Dhe ai edhe nuk e çoi matutje, edhe i la një porosi pastaj atij, domethanë, "Nëse ke forcë, nëse ke burrni", që veç e thashë në mënyrën time cila ishte burrnia, atëherë do ta falësh gjakun. Me fjalë të tjera, ka qenë me e qartë kush e fal gjakun. Mosfalja e gjakut në atë kohë, në ato rrethana ka qenë, ka qenë për mua dhe për shumë kënd, një lloj egoizmi, ani se une kam mirëkuptim për dhembjen e njerëzve, ama ti ke dalë dhe je vrarë në rrugë dhe s'ke pasë kujt t'i merr gjak. Nga policia, nga ushtria, je arrestu, je torturu, je... je ardhë n'kufirin e jetës edhe kujt ke pasë për t'i marrë hak.

E vetmja hakmarrje ka qenë t'luftosh për jetën dinjitoze. Njerëzit që s'kanë pasë forcë me falë gjakun,

kanë pasë një problem me veten, kanë pasë një problem me veten, s'kanë pasë forcë. Për çfarë arsye? Mund t'shikohet secili rast veç e veç, por megjithatë, me shumicë, njerëzit kanë tregu një forcë dhe kanë bërë një burrnë të jashtëzakonshme, një burrnë që ka kapërcy shumë e shumë, veç atë burrninë e definuar të burrit të odës së burrave.

Erëmirë Krasniqi: Kur filloi aksioni, u shpërndatë në viset tjera shqipfolëse. A shkojshit edhe ju atje?

Hava Shala: Po, kemi shku. Për shembull, ne kemi nda, jo në mënyrë të prerë, po ka qenë e vetëkuptueshme dikush do t'shkojë në Mal të Zi, dikush do shkojë në Maqedoni, dikush do shkojë në Preshevë e Bujanovc, dikush do shkojë në këtë zonë, dikush.... Varësisht prej rasteve të vështira ose nismës, osht' dashtë me qenë dikush me përvojë dhe dikush që ka qenë i nderuar në.... E mbaj n'mend në Malësinë e Gollakut, patëm shku nihere me Akile Dedincën, me Rrahman Dinin dhe me ni shoqe tjetër që e ka njoftë ma shumë Akilja, m'vjen keq po nuk ia mbaj n'mend emrin. Rrahman Dini ka vdekë menjëherë pas luftës, ka marrë pjesë në luftë. Ka qenë njeri i mrekullushëm, njeri pa anime politike, pa parti, pa... thjeshtë një person atdhetar. Kemi shku në Gollak, në një fshat në Gollak. Edhe, edhe atje ishte... e lamë veturën poshtë edhe shkumë atje naltë dhe bisedumë edhe ka qenë shumë interesante ajo pritja që na bëni burri i asaj shtëpie.

Tha, "Mirë se keni ardhë se kurrë ma mirë s'ia keni qëllu". Edhe ne filluam ato ceremonitë, "Si jeni, tek jeni?" Edhe tha, "S'keni nevojë hiç me m'tregu kush jeni, unë e di kush jeni". Tha, "Edhe po ju thomë edhe diçka, keni ardhë në kohën e duhur. Jo që s'ka pasë burra t'mirë e që s'em kanë ardhë ma përpara n'odë." Tha, "po, ose m'kanë ardhë burrat e mirë n'kohë të keqe, ose m'kanë ardhë burra të këqi në kohë të mirë". Tha, "Edhe asnjëri s'është përputhë, s'e ka gjetë momentin. Ju keni ardhë," thotë, "njerëzit e mirë në kohën e mirë". Kurrë nuk e harroj! Ka qenë diçka, një formulim i jashtëzakonshëm i tij. Dhe biseduam edhe përafrohem rastin edhe na përcolli. Natyrisht asnjë rast nuk është falë në herën e parë, po që në herën e parë e ke ditë pak a shumë se "dita e mirë shihet në mëngjes", thotë populli.

Pastaj na përcolli ai deri poshtë, deri jashtë edhe ai kishte... ne ishim, duhet t'them edhe diçka. Ne kemi qenë t'shumbtën e rasteve, për një vit rresht, t'shumbtën e rasteve kemi qenë gati të pa hongër e pa pimë sa duhet. Këtë duhet ta them publikisht, ta tregoj, ta ilustroj me këtë rast në Gollak. Kur dolëm jashtë, ai tha, i kish pasë dhentë jashtë në shpat edhe sa për t'biseduar unë i thomë, "Paske dhenë të mira." Thashë, "A po e zini djathin e mazitur apo t'pamazitur?" Edhe ai po thotë, "Ku merr vesh ti..." Jo {korrigjon veten} "A pe shitni djathin e mazitur apo t'pamazitur?" Tha, "Ku merr vesh ti për dhenë?" Thashë, "Kur kam qenë e vogël, jam rritë me dhenë. S'i kam pasë shumë qejf, po djathin e mazitur e kemi shitë, e t'pamazitur e kemi hangër te shpija", me shaka edhe pse ishte diçka e vërtetë domethanë. Në familjet e mëdhaja s'ka qenë gjithmonë jeta qysh është dukë. Edhe ai thotë, "Ha, ti e din çka është djathi i mazitur?" Thashë, "Po, e kemi hangër kanjiherë, veç është shitë". Edhe ai thotë, "Pritni pakëz". Edhe e thirri grunë e vetë për emër e thotë, "Gruja jeme i ka qitë bukët n'qerep¹, edhe janë bukët e nxehta. Nuk keni me shku pa e marrë një copë bukë të nxehtë me djathë t'pamazitur se unë nuk e shes

¹ Tepsi e dheut, me të cilën është pjekë buka në oxhak.

krejt djathin e pamazitur”. Edhe nuk na la me shku edhe shkoi shumë shpejtë, e ndau një bukë të madhe n’katërshe, ne ishim katër veta. Edhe e kishte futë nganji copë të madhe t’djathit të pamazitur, djathi i pamazitur është djathi që s’i merret maza, është i mirë, është i shijshëm.

Dhe ne hangrëm aty bukën dhe ecëm ma tutje, Rrahmani ndjesë pastë tha, “Kurrë n’mos ia paqe pa hajrin dhenëve tuja, sot ia pamë hajrin” (qeshë). Ne hongrëm bukë atë ditë pas një kohe shumë të gjatë, edhe jo rrallë ne kemi qenë pa hangër e pa pi, por kemi me kohën, njerëzit kur kemi kalu fshatërave na kanë qitë diçka me hangër, me kohën. Jo kanë gatu si te Verat e Llukës, në mënyrë krejt vullnetare kanë gatu fshati, ose veç kanë dëgju për shembull n’Istog kanë dëgju që jemi aty. Njerëzit kur kemi dalë na kanë pritë me pite, me gjëra që ata kanë... secili në mënyrën e vetë kanë kontribui. Ama, e mbaj n’mend, jo rrallë ka qenë me t’vërtetë ne kemi metë pa hangër pa pi. Sidomos për shkak se ishte edhe ora policore prej orës tetë, ishte mundësia për t’shku te dikush me hangër darkë, ose m’u kthi te shpia, ishte bukur e vështirë. Edhe kjo ka qenë një fakt.

Erëmirë Krasniqi: Për çfarë arsye, po mendoj ku e gjejshin këta motivin me falë gjakun, meqenëse nuk ishin t’u jetu nën trysninë e Serbisë n’Kosovë? Çka ish motivi i tyre?

Hava Shala: I njerëzve jashtë Kosovës po mendon?

Erëmirë Krasniqi: Po.

Hava Shala: Aty ishte ndjenja, populli ishte, populli ishte kompakt, ishte ndjenja patriotike, ndjenja atdhetare, ndjenja se duhemi me qenë bashkë, jemi bashkë padrejtësisht jemi të ndarë. Ka qenë shpesh herë e thënë në kontekste t’ndryshme, populli është si një lum, kur lëvizë, atëherë është i tëri, nuk mundesh me thanë, “Kjo pjesë le t’rrin anash”. Dhe kështu ishte edhe populli, pjesa e popullit shqiptar në atë kohë, hala në Jugosllavi.

Erëmirë Krasniqi: Qysh u përmbledhë Aksioni i Pajtimit t’Gjaqeve?

Hava Shala: Në fakt, ne patëm mendu për një vit me qenë aksioni i pajtimit t’gjaqeve me kusht që me u kriju një vetëdije e re, me kusht që me u dhanë një porosi e qartë, jo me gjakmarrje. Me kusht që me u kriju një kulturë tjetërfare e bashkëbisedimit t’problemeve, ne nuk kemi shkuar thjeshtë për gjakun. Ne kemi folë edhe për shumë gjëra tjera, kemi folë për jetën, për mungesat, për mundësitë. Ka qenë një aksion shumë ma komplet se sa... me ndonjeri kemi shku për faljen e gjakut dhe kemi folë veç për gjakun, ne kemi folë edhe në të ardhmen, ne kemi folë edhe për rrethanat aktuale politike, për kufizimet, për padrejtësitë, për mundësitë e reja që do t’kishte populli nëse do t’ishte i lirë, për mundësitë tona si popull, për aftësitë tona, për një jetë paqësore.

Ne kemi shikuar, ne kemi konfrontuar shpesh herë veten tonë dhe njerëzit me t’cilët kemi biseduar, me pamundësitë që i kemi dhe me mundësitë që do t’i kishim duke e potencuar atë që kemi mundësi, nuk na mungon asgjë, nuk kemi kurgjë mangut nga popujt e tjerë, veç rrethanat na kanë bërë të ndryshme. Moshkollimi është një pasojë e rrethanave, për shembull. Përndryshe, ne jemi si gjithë popujt tjerë. Domethanë, në një mënyrë e kemi ngritë një vetëbesim tek njeriu me t’cilin kemi folë edhe një... edhe e

kemi nxitë një vetëdije t' re për veten tonë sot dhe për veten tonë në të ardhmen. Prandaj, edhe e qujta një lëvizje mjaft emancipuse, dhe emancipuse nuk e mendoj vetëm për gratë, e mendoj edhe për burrat, e mendoj përgjithësisht.

Erëmirë Krasniqi: E qysh... çka ndodhi me këtë participim të krejt qytetarëve? A erdh... kur u përmbyllë pajtimi i gjaqeve, a u ndi najfar ndryshimi imediat, naj lehtësim?

Hava Shala: Aksioni nuk përfundoi ashtu në mënyrë të prerë. Për shembull, me thanë me 2 gusht të '90-tës ka fillu aksioni, me 2 gusht të '91-tës ka fillu. Aksioni nuk u përmbyllë në mënyrë të prerë dhe filloi ajo faza tjetër që quhet gjithmonë problematike, veçanërisht në Ballkan, ana politike, dimensionin politik i aksionit t'pajtimit t'gjaqeve. Dhe pikërisht aty kujtoj që fillunë pakëz, një lloj çoroditjeje e vogël nuk du me thanë se nuk është bërë edhe ma tutje punë e mirë. Absolutisht çdo pajtim i gjaqeve ka vlerën po aq t'madhe sa cilido pajtim që është bërë brenda asaj kohe, po sikur fillunë, "Jo unë", "Jo ti", "Jo partia", "Jo mos partia", "Jo kjo", "Jo ajo" gjë që unë nuk kam qenë. Unë si person kam pasë trysni me deklaru se është bërë me iniciativën e kësaj partie, partia tjetër ka qenë kundër, unë kam thënë, "Jo". Nuk ka qenë absolutisht e vërtetë ajo që aksioni është filluar nga një parti.

Ne kemi qenë, unë s'kam asnjëherë pas burgut me asnjë parti. Thjeshtë e kam pasë mendimin tim politik, jam ndi e kufizuar në parti të ndryshme politike, n'fund t'fundit është e drejtë e secilit me qenë. Por edhe të tjerët nuk kanë qenë patjetër në parti të ndryshme politike dhe është çështje krejt personale kush ku ka qenë. Po unë kam qenë e bindur, dhe ka qenë e vërtetë që aksioni nuk ka qenë pronë as terminant i një partie politike, absolutisht. Thjeshtë ka qenë një lëvizje gjithëpopullore e të gjithë njerëzve me çfarëdo mendimesh politike, me çfarëdo partish politike pa asnjë parti politike. Ka marrë pjesë kisha e xhamia, njerëzit e ndërgjegjshëm, njerëzit që e kanë dashtë, e kanë dashtë njeriun e lirë në këtë vend dhe lirinë e këtij vendi.

Për kë arsye nuk i lejoj vetëvetes me thanë qi ky ose kjo, ai ose ajo ka pasë ma shumë ose ma pak. Secili ka bërë për maksimumin e vetë dhe maksimumi na bën t'gjithëve t'barabartë. Nëse unë kam mund diçka ma shumë me bërë dhe tjetri ka mund ndoshta diçka ma pak se unë, po për të ka qenë maksimumi, për mu është njisoj. Ai ka dhënë maksimumin e vetë sikurse unë që kam dhënë maksimumin tim. Unë pastaj në gusht të '91-tës jam larguar nga Kosova dhe e di që atë kohë ka pasë filluar mu mbajtë mbledhjet. Natyrisht që ishte edhe qëllimi me i sistemu gjërat, duheshin fakte, une i kuptoj ato, por kisha përshtypje që një lloj shtrese politike ku pasqyroheshin edhe tendencat, inatet, lakmitë. Nuk ka qenë dominante, po ka qenë pak a shumë një përzirje. Ka qenë diçka paralel me vetë aksionin. Kam dëgju pastaj, nuk jam dëshmitare e faljes t'matutjeshme, po ka pasë gjithënjë matutje njerëz, grupe t'caktuar që kanë ndihmuar, kanë ndikuar.

Ka edhe ma tutje me siguri, gjithësesi është një punë humane, unë kam qenë e bindur që, kam qenë e bindur mesazhi është dhënë i qartë. Lëvizja ka qenë e pastër që nuk do t'duhesh me u kthi... qoftë edhe minimalisht, një lloj tendence me personalizuar aksionin ose me ia atribu vetëvetes ose dikujt. Unë kam qenë atëherë edhe jam edhe sot e bindur që aksioni ka pasë karakter gjithëpërfshirës, ka luftë rolin e tij t'jashtëzakonshëm në mobilizimin e njerëzve, në ndërgjegjësimin e njerëzve, në

emancipimin e njerëzve, këtë ndihmë e kam edhe sot, edhe atëherë e kam pasë.

Erëmirë Krasniqi: Ka pasë aktivistë nërradhët e juaja që janë persekutu? A kishe mujtë diçka me na tregu për këtë aspekt?

Hava Shala: Hmm, Nurie Zeka është faktikisht vajza e hallës time. Naser Veliun e kam njohur pak, fare pak, mos gabofsha nëse e kam takuar një herë, s'jam shumë e sigurtë, më shumë e kam... mos gabofsha e kam takuar një herë në Pejë, por s'ka rëndësi. Ajo, ata janë larguar respektivisht kanë udhëtuar bashkarisht për Zvicër me veturën e Naser Veliut. Dhe në atë kohë, koha e aksionit të pajtimit t'gjaqeve është si një shtëpi me shumë kthina. Dhe përveç asaj kthinës t'madhe t'ashtuqujtur Aksioni i Pajtimit të Gjaqeve, ka pasë edhe kthina tjera që kanë ndodhë lëvizje të ndryshme si pjesë e lëvizjes të asaj kohe.

Dhe një prej atyre lëvizjeve kanë qenë edhe angazhimi i njerëzve për ta hulumtu, për ta definuar gjendjen... që ishte n'atë kohë aktuale me helmimet, helmimet e studentëve të nxënësve. Ishte një kapitull në kuadër të këtij kapitullit t'madh. Dhe, për aq sa unë di, Nuria ka pasë disa të dhëna nga një spital apo nga spitale të ndryshme të analizave të ndryshme të disa studentëve ose të njerëzve të helmuar. Dhe, ata janë nisë me shpresë që ndër të tjera ato analiza mund të bohen ma mirë në Zvicër dhe mund të dihet ma shumë sepse dikush i quante histeri kolektive, dikush i qunte helme ruse, dikush i qunte... Ishte një gjendje e padefinuar, ishte një lloj traume gjithashtu. Edhe ata janë aksidentu në Beograd. Është thanë, është shkru, është thanë, është dëgju se ata janë aksidentu qëllimisht. Për mua ka qenë e rëndësishme, pa marrë parasysh mënyrën e aksidentimit, Nurija, për Naserin di shumë pak. Për Nurinë, ajo ka qenë pjesëtare e Aksionit të Pajtimit të Gjaqeve. Është nisë me shku në Zvicër tek i vëllai dhe ka pasë këto gjëra që i thashë me vete, me dëshirë, me shpresë se mund të di diçka ma shumë rreth ktyre gjërave. Kaq di unë dhe kaq them unë për veten time.

Por natyrisht që pa marrë parasysh a është Nurija, apo është Hava, apo është Ilirja, apo kushdo qoftë tjetër me çfarëdo emri. Nëse ti je përndjekë, ke qenë aktiviste n'çfarëdo mënyre për çështjen e atdheut në atë kohë, je arrestuar, faktikisht ti ke qenë e rrezikshme. Nuk është dashtë shumë për t'u definu si e rrezikshme nga policia dhe nga institucionet tjera.

Erëmirë Krasniqi: Arsyea pse ju keni emigru mandej, a ka pasë të bëjë me këtë?

Hava Shala: Po, ndër të tjera. Në qershor u mbyll fakulteti, unë kam dhënë provimin e fundit n'atë kohë, ka qenë Letërsi Popullore, edhe u ndalua është e njohur për t'gjithë. Në ndërkohë fillunë arrestimet të tjera, Myrvetja veç ishte arrestuar ma përpara, burri im më pastaj, se atëherë kam qenë e fejuar, ka qenë duke dhanë mësim n'atë kohë në shkollën "Shtjefan Gjeqovi" pjesërisht edhe në shkollën e... në Fakultetin Xehëtar Metalurgjik në Mitrovicë dhe atje i erdhi thirrja. N'atë kohën vinin thirrjet kolektive për... kolektive masive për ushtri dhe koha ishte shumë e vështirë. Dhe ne e kemi menduar për një kohë për t'u larguar si gjithë mërgimtarët e përkohshëm e t'përhershëm. Dhe ne jemi larguar në gusht pasi kemi lidhë kurore ilegalisht në Baran, të shtunën msheftas, sepse ne nuk kemi pasë mundësi, thjeshtë në mënyrë krejt të ligjshme n'atë kohë me lëvizë. Ne e kemi pasë caktu një datë për martesën pas dy muajsh, mirëpo gjithëçka ka shku krejt ndryshe. Arsyea ka qenë ajo, dhe të tjerat

pastaj.

Ka qenë një dëshprim, një dëshprim për rrethanat politike. Unë kam pasë mendimin që politika sigurisht që politika pasive ka pasë.... Secili njeri ka një rol dhe mund t'bëjë diçka të mirë kudo qoftë. Dhe secila parti e asaj kohe sigurisht ka pasë një qëllim t'mirë dhe ka bërë diçka t'mirë. Dhe secilido politikan që e ka rreziku veten për t'thanë diçka, për t'bë diçka, për t'u organizu në çfarëdo mënyre, sigurisht ka bërë.

Unë për veten time, nuk kam qenë e bindur se shumë në mënyrë pasive mund të bëhet diçka. T'thomë sinqerisht unë kam qenë, kam qenë, kam qenë pak shumë e zhgënjyer, jo prej një personi por përgjithësisht rrethanat. Njerëzit merrnin thirrje masive për ushtri, s'ishte rastësi. Tendencia ishte të gjithë me i heqë burrat. Ne ishim keq të organizuar, keq të organizuar për t'marrit me mend për mua. Ka qenë edhe një lloj dëshprimi t'thomë sinqerisht. Edhe ajo ka qenë një faktor. Edhe mbyllja e fakultetit, edhe... s'kam qenë shumë e bindur se mund të bëhet diçka veç me politikën paqësore.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e paramendojshe?

Hava Shala: Për shembull, për mua ka qenë e vështirë si njeri me pa poshtërimin, përndjekjen e përditshme edhe mos me bo kurgjo, me dalë në media me thanë diçka, e ka ajo rëndësinë e vetë natyrisht. Edhe shpia e madhe e ka pasë një përfaqësus, e ka zgjedhë një përfaqësus, e ka zgjedhë zakonisht mashkullin ma t'mençur, e kanë çu në raste të ndryshme me e përfaqësu familjen n'festa ose n'vdekje. Me fjalë të tjera edhe Kosova atëherë, natyrisht e ka pasë nevojën me i pasë njerëzit që kanë bo diplomaci, që kanë folë mirë, kanë folë guximshëm. Pa dyshim, nuk du me thanë se veç kjo që unë kam menduar do t'ishte rruga e vetme. Njerëzit kanë mundësi të ndryshme, po sikur edhe veç kufizimi, veç kufizimi në një rrugë ishte për mu relativisht ngushtë, relativisht. Kam qenë e bindur që njerëzit duhet t'bëjnë diçka ma shumë. Unë kam qenë e bindur, siç edhe ma vonë e ka treguar jeta, që pa u organizu, atëherë kam mendu një lëvizje guerille që lëvizë, e që nuk e len policinë lirshëm me lëvizë nëpër toka. Thjeshtë një lëvizje që kombinohet pakëz edhe me politikën edhe me diplomacinë edhe me... por edhe me lëvizjen n'rrafshin e përditshëm.

Për shembull, një herë i kam thënë një mësueses zvicerane, një herë kam pasë edhe ligjeratë për... po bëj një shprehje t'vogël, për disa mësues zviceranë. Dhe një mësues kur thashë une në këtë vit u çliru Kosova, e thashë spontanisht dhe ishte e vetëkuptueshme për mua, thashë, "*Gott sei Dank*", falë Zotit edhe ajo e bëri një grimasë që mua nuk m'pëlqei. Si një... sikur t'më thoshte, "S'ka kjo t'bëjë me mua nëse Kosova është e lirë ose jo, është shlyrur ose jo". Mirëpo, une i thashë... edhe ajo nuk tha kurgjë me t'vërtetë, ama une nuk munda me kapërcy atë farë, një lloj i veprimi diçka, diçka që nuk m'la rahat. E i them unë, them, "Po, unë duhet ta them edhe një herë që ka shumë rëndësi kjo që po e them unë, çlirimi i Kosovës, dhe ka rëndësi edhe për temën që sot po e bisedoj". Tema ishte, "Bashkëpunimi me prindërit e kulturave t'ndryshme – mënyra, empatia", edhe kështu me radhë.

Unë e kam bërë një kualifikim për komunikimin ndërkulturor në Zvicër. Dhe, i thashë asaj kçtë që po e them tash edhe për ju të dyve {i drejtohet të pranishmëve}, i thashë asaj, "Merreni me mend sikur ju t'kishit ardhë sot tek unë me një autobus nga një x fshat, me një autobus këtu dhe në rrugë e sipër, ju

ndalë policia dhe ushtria e një vendit. Dhe, njëri polic hyri brenda edhe merr një mësus ma i vjetër që ishte n'mesin e atyre, ishin diku 20-30 vetë dhe ne me një anë e marrim me mend se ky është shoferi, ky zotëriu këtu është shoferi. Dhe polici hyn, e merr shoferin ku jeni ju t'gjithë në autobus. E kthen me ftyrë prej jush, ia jep shuplakë në ftyrë, e pshtynë në faqen tjetër dhe i thotë, 'Ulu!', na shikon neve, zgërdhihet dhe i thotë, 'Vozit!'" Them, "Prandaj ka rëndësi për mua ta thomë sot që prej kësaj kohe, me migrantët e tjerë që vijnë këtu, ka një tjetër histori. Dhe migrantët shqiptarë deri në këtë kohë, ka një tjetër histori, prandaj po e them këtë". Në një mënyrë e inkorporova brenda temës që e kisha.

Dhe po e them tash në pytjen tënde, për mu ka qenë e pa marrun me mend m'u kufizu aq shumë jeta sa njeriu mos me mund me dalë n'pazar me shitë një, fshatari me shitë një thes pasul ose... e vetmja mënyrë për t'egzistuar, për t'mbiegzistuar, ose për t'u pshtyer, për t'u gjujtë, për t'u denigru edhe për t'thanë, "Mu m'mjafton edhe nëse dalë edhe vetë edhe dalë për t'dhanë një deklaratë politike". Unë po flas për veten time, shyqyr që nuk janë krejt njerëzit njësoj, po unë kam qenë prej fillimit e bindur që do t'duheshin edhe forcat tjera, jo kundër njëra-tjetrës por bashkë me njëra-tjetrën, ose krahas njëra-tjetrës. Kjo ka qenë përshtypja ime dhe një prej arsyeve t'thella që kam dalë, ose t'para që kam dalë ka qenë pikërisht kjo pikë e zhgënjimit.

Erëmirë Krasniqi: E qysh ka qenë mandej jeta juje në Zvicër?

Hava Shala: Pastaj ne jemi larguar si refugjatë. Unë kam për vete një përvojë shumë pozitive në intervju atje, ka qenë rend të merresh dy deri në tri herë në intervju. Unë jam marrë niherë pak, fare pak sa për t'u njoftë dhe dy herë relativisht gjatë ku e kam... në mungesë të dokumentacionit është dashtë me qenë bukur i imtë rrëfimi për ngjarjet në Kosovë, për rrezikun, rrezikshmërinë, shkallën e rrezikshmërisë për veten tënde. Dhe une e kam rrëfyer atë, e kam rrëfyer duke shpjeguar rrethanat. Duke shpjeguar rreziqet, duke shpjeguar t'kalumen time edhe personale. Ka qenë e besushme, m'kanë dëgjuar që është përdorë edhe për verifikimin e deklaratave tjera pastaj. Dhe pas dy-tre muajsh, tre muaj të plotë jemi pranuar si refugjatë dhe kemi bërë rrugën tonë pastaj jetësore atje. Unë kam qenë me shëndet jo mirë, kam pasë shumë problem pas daljes nga burgu me këmbë, me shputat e këmbëve. Kështu që jam marrë fillimisht ma shumë me medicinë.

Burri im ka studiuar relativisht shpejtë, pjesën pedagogjike të matematikës, sepse nuk është pranuar ajo pedagogjia socialiste. Dhe relativisht shpejtë ka filluar me përkthime, unë n'anën tjetër kam qenë, kam filluar t'punoj si mësuese e Gjuhës dhe Kulturës Shqipe, atëherë falas sepse natyrisht kurset që janë financu nga ambasadat jugosllave t'asaj kohe, nuk janë financu ma tutje, e kuptushme. Dhe ne jemi mobilizu si migracion dhe kemi punu vite t'tëra, kemi punuar falas ose kryesisht falas. Ka qenë mirë për mua, ka qenë një përmbushje e vetes time në migracion. Pastaj ma vonë jam ba nanë dhe kam dashtë me bërë diçka tjetër për fëmijë, kam dashtë me sfidu pak veten me një tjetër mënyrë të rritjes, me një tjetër mënyrë të edukimit. Dhe kam bërë një shkollim për udhëheqëse për grupe t'lojes. Kam punuar katër vite me fëmijë në kohën e luftës, me fëmijë e traumatizuar kryesisht, me persona profesionistë të traumave, dhe jo vetëm. Kam punuar me shumë qejf, i du shumë fëmijë, shumë, shumë, shumë, shumë. Mbi të gjitha, i du njerëzit përgjithësisht.

Më pastaj, e kam parë që komunikimi ndërkulturor i njerëzve tanë me institucionet e Zvicrës, nuk ka qenë i thjeshtë, nuk ka qenë i lehtë. Njerëzit kanë qenë të frikësuar, njerëzit kanë qenë të shqetësuar, njerëzit kanë qenë të zorshëm, njerëzit kanë qenë... kanë ardhë, për shembull prej rrethanave të vështira në Kosovë edhe ka mendu që është e vetëkuptueshme që, zvicerani veç pse e din që në Kosovë është vështirë, duhet me kuptu atë. Zvicerani pa folë nuk kupton, ajo që thua ajo është, ajo është pjesë e jotja. Përndryshe s'ka, s'është kurgjë e vetëkuptueshme. Dhe institucionet njikohësisht e kanë pa që njerëzit vijnë, a nëse kanë punuar si udhëheqëse e grupeve t'lojes, kanë ardhë njerëzit edhe për t'i pru fëmijtë, por edhe ndonjëherë kanë qëndru edhe një orë edhe dy orë ma gjatë me shkresat e tyre, me këshillimet e ndryshme. E pastaj ajo qendra e kulturës ka qenë... ka ra n'sy që vijnë gjithmonë njerëzit.

Edhe një ditë prej ditëve, m'viziton një grua që ishte udhëheqëse e një qendres profesioniste, e një byro e qytetit të Winterthurit që quhet *Fachstelle Für Intergration Winterthur* [Agjencia për Integrim e Winterthurit]. Thotë, "Kam dëgjuar, njerëzit vijnë tek ti". Ata kishin pasë, përballë kanë një grua serbe, mirëpo njerëzit nuk kanë shku më tek ajo. Edhe pse ajo ka qenë një njeri i mirë në fakt. Mirëpo njerëzit s'kanë pytë atëherë, domethanë vetë gjuha, vetë emri ka qenë një kufi në vetëvete. E kuptueshme gjithashtu edhe ajo m'thotë se, "Kishim dëshirë shumë me ardhë pjesërisht me punu tek ne si këshilltare". Dhe pastaj kam fillu edhe aty pjesërisht dhe tendencialisht kam qenë gjithnjë ma e kërkuar edhe pastaj bëra një shkollim plotësues për mësimdhënie në klasët heterogjene sepse mësimdhënia e kurseve t'ndryshme u intergu, u bo pjesë e integruse e shkollave t'rregullta. Për mu kanë qenë shumë interesante gjërat që bëhen ndryshe. Gjithmonë kam dashtë diçka ma ndryshe.

Edhe, kështu që e bëra edhe aty një shkollim një vit, pastaj kam ndjekë edhe nja dy module për komunikim interkulturor. Dhe në këtë pikë ndoshta m'ka ndihmu shumë, shumë, shumë, shumë komunikimi në Aksionin e Pajtimit të Gjaqeve. Mund t'them padyshim ka qenë një studim i llojit të veçantë, gjë që jam e bindur për këtë që po e them. Ka qenë përvojë, ka qenë një sprovë, ka qenë një provim për mua. Dhe ndoshta edhe të tjerët e kanë vërejtë dhe më pastaj jam, kam qenë ma aktive. Një kohë të gjatë kam qenë si përcjellje familjare, kam bërë shkollimin plotësues si mësimdhënëse në klasët heterogjene. Dhe, me këtë kualifikimin për komunikimin ndërkulturor jam kualifiku si pedagoge sociale dhe natyrisht që ajo ka qenë një mundësi e re për mua. Dhe kam punuar dhe punoj edhe ma tutje me institucionet e ndryshme në rastet ku familjet kanë vështirësi, edukimi i fëmijëve është një temë, fëmijtë kanë mungesa ose pengesa të ndryshme. Familjet nuk gjejnë zgjidhjet të duhura, thjeshtë jam me një përqindje prej 60 përqind punoj edhe sot e kësaj dite si pedagoge sociale.

Dhe, pjesërisht punoj 20 përqind si këshilltare në këtë byronë e qytetit të Winterthurit dhe dikun lëvizë, 10-5, 15-20, ma shumë ma pak, lëvizë një punë që e bëjë zakonisht vullnetarisht për njerëzit me nevojë. Për shembull, i bëj shkresat falas ose ju shkoj ndonjëherë falas për t'iu përkthi se s'ke çka ju merr, veç nëse ju merr shpirtin. Ky elementi në Aksionin e Pajtimit të Gjaqeve, ku njeriu e sheh se jo vetëm paraja është diçka që quhet përfitim, është edhe një ndjenjë e mirë, është edhe një... ndjenja e solidaritetit është ndjenja shumë e fuqishme tek unë, edhe besoj tek shumë njerëz. Dhe këtë e bëj për qejf, e bëj ma tutje varësisht nga rrethanat, nga shëndeti. Kurse burri im punon si mësimdhanës i matematikës në... edhe ai ka qenë tri vite i burgosur politik ma përpara. Dhe punon edhe ma tutje si

mësimdhanës i matematikës në gjimnaze të ndryshme.

Erëmirë Krasniqi: A kishit dashtë edhe diçka tjetër me shtu? Po mendoj që qitu mujmë me e përmbyllë.

Hava Shala: E kam dëgjuar një herë një shok i imi, ai i cili ka qenë, ka qenë lart i ranguar në politikë, shok dhe i afërm i imi. Thotë, pas ardhjes time prej Zvicrës thotë, “Ti e ki bë mirë, e ki kry punën tande dhe tash shikoni jetën tande”. Edhe ajo m’preku pak a shumë sepse nuk ishte ashtu. Ai mendonte se nëse njeriu është larg, edhe atdheu është larg. Varet qysh njeriu, çfarë marrëdhënie krijon me atdheun. I ngjan ndoshta një lloj vetëlavdërimi, po për Kosovën mund të them deri tashi me siguri ka mbi 200-300 *vorträge* [Gjermanisht: ligjerata] quhen, referate; takime me studentët, me mjekët, me institucione të ndryshme ku flas për rrethanat, për njeriun, për nevojën që ka njeriu për t’u kuptu për t’u përkrahë. Edhe tash e kësaj dite, tash para pak ditësh, isha në shkollën e lartë pedagogjike në Lucern. Dhe, shkëputja ime nuk është... nuk është bërë as shkëputje fizike dhe absolutisht jo shpirtërore për mu. Edhe kur i qortoj shokët e mi që janë në politikë, i kritikoj, e bëj për shkak se e dua Kosovën.

Kosova nuk është pronë e jona, kam frikë që, kam frikë që... këtë nuk do ta them publikisht, por po e them që kam frikë që një shumicë e njerëzve dhe shumicë e tyre janë shokë të mi nga e kaluara, e kanë harruar mesazhin që ne ju kemi dhanë të tjerëve. Dhe kam frikë që kjo Kosovë për t’cilën kam shpresuar që edhe nëse vetë nuk mbijetoj, të paktën të rinjët, fëmijët, njerëzit e këtij veni, do t’kanë të drejtë ta bëjnë një jetë me dinjitet, nuk është e tillë. Kam frikë që ata, ne të gjithë mbajmë përgjegjësi për një gjurulldi të Kosovës së sotme, të cilën nuk e kemi ëndërruar të këtillë. Prandaj, shkëputja ime nuk është as fizike, as shpirtërore me Kosovën. Dhe lidhja ime me Kosovën fatkeqësisht është hala një dhimbje, është një lidhje që ka dhimbje në vetëvete për faktin se njeriu është hala i varfër për shkak se kam frikë që është kuptuar keq që atdheu është bërë pronë e njerëzve t’caktuar. Më dhemb shumë ma shumë se sa në kohën kur kemi menduar i huaji e hanë tokën, neve, njerëzit, të ardhmen, të tashmen. Mundohet me ndryshu të kalumen sepse ajo ka qenë për mua e vetëkuptueshme, ka qenë ai i huji që nuk na ka dashtë ekzistencën tonë. Lidhja ime me Kosovën sigurisht do t’jetë deri në thënie popullorqe, deri në dërrasën e varrit (buzëqeshë). Kaq kisha dashtë me thanë. E dua hala Kosovën. Për mua është hala ajo Kosova e andrrave t’mija, kam frikë me iu kthi plotësisht Kosovës së tashmë sepse kam frikë mos zhgënjehem tërësisht dhe nuk dua t’zhgënjehem tërësisht.

Erëmirë Krasniqi: Shumë falemnderit.

Hava Shala: Falemnderit edhe prej jush.